



Agjensia e Zhvillimit
të Zonave Malore

Udhëzues metodik
i planifikimit të zhvillimit
lokal me pjesëmarrje



Agjensia e Zhvillimit te Zonave Malore

UDHËZUES METODIK I PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT LOKAL ME PJESMARRJE

Tiranë 2009



Ky udhëzues metodik botohet nga Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore - MADA në kuadër të "Programit për zhvillim të qëndrueshëm të zonave rurale malore", të financuar nga Qeveria Shqiptare, IFAD dhe OFID.



Me porosi të MADA-s, ky material është hartuar nga ACER (Qendra shqiptare për Kërkime Ekonomike)

Në këtë material kanë dhënë ndihmesën e tyre:

Dr. Shkelzen MARKU (Drejtor Ekzekutiv i MADA-s)

Msc. Roland BARDHI (Manaxher i sektorit të Zhvillimit Rajonal)

Përshtatur për botim: **Ilir SHORDJA**

©

MADA (Mountain Areas Development Agency - Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të kopkohet me çdo mjet e forme qoftë, duke përfshirë fotokopje, kopje, regjistrim i plotë apo I pjesshëm, ribotim pa lejen paraprake të Agjensisë së Zhvillimit të Zonave Malore - MADA

Për më shumë informacion, kontaktoni në adresën:

MADA, Rruga "Shinasi Dishnica", nr. 100, pranë Selvisë
Tel.: +355 4 2267542; Tel. & Fax.: +355 4 2267544
www.redeval.org email:mada@redeval.org

Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA), me mbështetje të Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD) dhe të Qeverisë Shqiptare po zhvillon fokusin e saj në një zhvillim të balancuar të zonave të de-favorizuara rurale malore të vendit, duke influencuar në diskutimin e politikave në nivel kombëtar dhe lokal në çështje social-ekonomike të këtyre zonave.

Brenda përpjekjeve të saj në proceset pjesëmarrëse dhe konsultative, MADA po mbështet krijimin e një platforme institucionale për pjesëmarrje komunitare në planifikimin dhe zbatimin e zhvillimit ekonomiko-social lokal dhe lehtësimin e zhvillimit të zonave malore. Kjo përfshin partneritetet në nivel lokal, forcimin e kapaciteteve të komuniteteve lokale dhe të qeverisjes lokale për identifikimin e nevojave dhe kërkesave për investime prioritare me pjesëmarrje të të gjithë aktorëve lokalë, të përfaqësuesve të shoqërisë civile, biznesit privat dhe të qeverisjes lokale..

Ne këtë kuadër, përgatitja e Planeve të Zhvillimit Lokal në aspektin afatgjatë konsiderohet shumë e rëndësishme për disa arsye:

Së pari, përmirësimi i planifikimit si një proces i qeverisjes lokale për të kuptuar dhe zbatuar më mirë funksionet e saj në lidhje me komunitetët lokale. Procesi i planifikimit është ndërtuar në një mënyrë që lejon dhe mundëson ngritjen e kapaciteteve dhe mundësitë trajnuese të stafit të pushtetit lokal. Nga ana tjetër ai përfshin një pjesëmarrje të madhe të të gjithë aktorëve lokalë, gjë që premtion vazhdimësi dhe dialog të qëndrueshëm ndërmjet të zgjedhurve lokalë dhe komunitetit, një partneritet ky i nevojshëm për të forcuar besimin dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin lokal.

Së dyti, Plani i Zhvillimit Lokal është një instrument i rëndësishëm për orientimin e integruar të përpjekjeve për zhvillim në nivel lokal. Ai i shërben identifikimit të burimeve dhe krijimit të mundësive për projekte zhvillimi konkrete dhe koherente në nivel lokal duke synuar përmirësimin e jetesës së këtyre komuniteteve.

Së treti, Plani i Zhvillimit Lokal mund t'i shërbejë Qeverisë, donatorëve, agjensive të tjera zhvillimore, bizneseve dhe pushtetit lokal për të studiuar dhe planifikuar më lehtë ndërhyrjet dhe marrjen më shpejt të vendimeve për investimet e tyre. Për këtë konsiderohet që Planifikimi Lokal duhet të koordinohet dhe bashkërendohet me plane të tjera zhvillimi rajonale dhe me strategjitë kombëtare.

MADA ka mbështetur gjatë 2 viteve të fundit procesin e përgatitjes së Planeve të Zhvillimit Lokal në disa komuna të rretheve Përmet, Mirditë, Shkodër, Pukë, M.Madhe, Librazhd, Gjirokastrë, Kolonjë dhe Tropojë me mbështetje financiare të IFAD dhe kjo eksperiencë e krijuar është konsideruar mjaft e vlefshme.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë ofruesit e shërbimit (konsulentët) për kontributin e ofruar në draftimin dhe pilotimin e metodologjisë së zbatuar, sikurse dhe sektorin e programimit të zhvillimit rajonal në MADA për rolin e tyre në tërë këtë proces.

Një vlerësim i veçantë bëhet për komunitetet dhe pushtetet lokale pilote ku është zbatuar kjo metodologji për pjesëmarrjen e tyre në realizimin me sukses të këtij procesi.

Shkëlzen Marku

Drejtor Ekzekutiv

Përmbajtja

SHKURTIMET	4
Hyrje	5
KAPITULLI I. METODOLOGJIA E PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT LOKAL	6
1. Qëllimi dhe Rëndësia e Udhëzuesit Metodik për Hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal me Pjesëmarrje	6
1.1 Disa Përkufizime dhe Terma të Zhvillimit Lokal	6
1.2 Çfarë është Zhvillimi Lokal?	8
1.3 Çfarë është Plani i Zhvillimit Lokal?	9
1.4 Pse është i Rëndësishëm Zhvillimi Ekonomik Lokal?	9
1.5 Pse Shërben Plani për Zhvillimin Lokal?	10
1.6 Qëllimi i Udhëzuesit Metodik	11
2. Përmbajtja e Planit të Zhvillimit Lokal	11
2.1 Komponentët, Prioritetet dhe Parimet Kryesore të Hartimit të Planit	12
2.1.1 Pesë komponentët kryesor të strategjisë	12
2.1.2 Katër Prioritetet e Zhvillimit Lokal	12
2.1.3 Parimet kryesore për hartimin e Udhëzuesit Metodik	13
3. Aktorët Pjesëmarrës në Përgatitjen e Planit të Zhvillimit Lokal	14
3.1 Qëllimi kryesor i veprimtarisë së MADA	14
3.2 Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (Grupi PZhL)	14
3.3 Nën-grupi i Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje (MVP)	15
3.4 Nën-Grupi për Zonat Prioritare	15
3.5 Si duhet të jenë të organizuara dhe drejtuara politikat e zhvillimit lokal? Cilat grupe duhet të përfshihen?	15
3.6 Planifikim Strategjik për Zhvillimin Lokal	16
3.7 Nevoja për planifikim strategjik	17
3.8 Drejtimi i Planifikimit Strategjik	17
3.8.1 Organizimi dhe sponsorizimi	17
3.8.2 Analiza e mjedisit	18
3.8.3 Identifikimi i çështjeve kryesore	18
3.8.4 Zhvillimi i objektivave dhe strategjitë e rekomanduara	18

3.8.5 Formulimi i planit të veprimit	18
3.8.6 Zbatimi i planit të veprimeve	19
3.8.7 Monitorimi i rezultateve	19
3.8.8 Drejtoria e Shërbimit Këshillimor mund të ndihmojë	19
3.9 Parimet kryesore të Planifikimit të Zhvillimit Ekonomik Lokal	19
3.9.1 Planifikimi duhet të jetë aktual dhe i rëndësishëm.	19
3.9.2 Planifikimi duhet të ketë qëllime të përcaktuara dhe ndara qartë	20
3.9.3 Koordinim me planet e tjera lokale	20
3.9.4 Njihni tregun tuaj	20
4. Kuadri Kohor	22
5. Masat per fillimin e procesit	22
KAPITULLI II. HARTIMI I PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL	24
1. 5 Fazat dhe 10 Hapat që duhen Ndërmarrë	26
Faza 1: Mbështetje Ndërtuese	26
HAPI 1: SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË LOKALE	26
a) Pse ndërtimi i Partneritetit Lokal është i rëndësishëm për Suksesin?	27
b) Cili është roli i grupit të PZHL-së?	28
c) Kush duhet të përfshihet në Grupin e Planit të Zhvillimit Lokal?	28
HAPI 2. PËRCAKTIMI I DREJTIMIT	30
HAPI 3. TË FILLOSH	30
Faza 2: Vlerësimi i Gjendjes	34
Hapi 4: Mbledhja e informacionit	34
HAPI 5. PJESËMARRJA KOMUNITARE	38
Faza 3: Hartimi i Planit	44
HAPI 6. PËRPUNIM TË DHËNASH DHE HEDHJE NË STRUKTURËN PARAPRAKE	44
HAPI 7. PUNA E NËNKOMITETIT TË FUSHËS PRIORITARE	47
HAPI 8. JU FOLËT NE DEGJUAM, A E KUPTUAM MIRË?	54
Kapitulli III MIRATIMI DHE ZBATIMI I PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL	56
3.1. Miratimi i Planit të Zhvillimit Lokal Nga Njësitë Vendore	56
Faza 4: Implementimi i Planit	56
HAPI 9. INTEGRIMI ME IDENTIFIKIMIN E BUXHETIT/FINANCIMIT	56
3.2. Monitorimi i Zbatimit të PZHL-së	58
HAPI 10. PËRSHTATJA E PZHL, IMPLEMENTIMI / FILLIMI I PME	58

SHKURTIMET

AGER	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
ADF	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
DELTA	Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave
FG	Grup i Fokusuar
GI	Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike
MADA	Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore
MVP	Monitorimi dhe Vlerësimi me Pjesëmarrje
NMDh	Nëngrupi i Mbledhjes së të Dhënave
NMK	Nëngrupi Mobilizimi i Komunitetit
OUJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
PVK	Panairi i Ideve për Vizionin Komunitar
PZhL	Plani i Zhvillimit Lokal
QRMA	Zhvillimi i Qëndrueshëm në Zonat Malore
SKZHI	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit
SME	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
SNZHR	Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Botëror
WB	Banka Botërore
IFAD	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë



Agjensia
e Zhvillimit
të Zonave
Malore

Udhëzues metodik i planifikimit të zhvillimit lokal me pjesëmarrje

Hyrje

Dokumenti “Udhëzuesi Metodik i Planifikimit të Zhvillimit Lokal me Pjesëmarrje” bazohet në një metodologji të hartuar nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), si pjesë e programit të MADA-s “Zhvillimi i Qëndrueshëm në Zonat Malore (SDRMA)” i financuar nga IFAD.

Në periudhën 2007-2008, MADA ka mbështetur disa nga komunat malore të vendit duke u ofruar asistencë dhe lehtësim të procesit të identifikimit të përparësive të zhvillimit të tyre dhe hartimin me pjesëmarrje të Planit të Zhvillimit Lokal (PZHL). Kjo mbështetje ka qenë përqëndruar kryesisht; si në ngritjen e kapaciteteve të aktorëve lokalë në identifikimin dhe përcaktimin e nevojave prioritare, ashtu dhe në ofrimin e asistencës në procesin e përgatitjes së draft strategjive, draft planeve të veprimit dhe projekteve prioritare për zhvillim lokal mbi bazë pjesëmarrje. Ndërtimi i kapaciteteve është fokusuar fillimisht në vlerësimin e nevojave me pjesëmarrjeje, analizën e varfërisë, identifikimin e përparësive zhvillimore, përcaktimin e vizionit, objektivave, planeve të veprimit dhe kuadrit përkatës të vetë-vlerësimit. Kjo mbështetje, u është ofruar gjatë këtyre dy viteve të fundit 10 njësive vendore në rrethin e Përmetit, 8 në rrethin e Mirditës, 1 në rrethin e Matit, 4 në rrethin e Pukës, 4 në rrethin e Gjirokastrës, 2 në rrethin e Librazhdit, 2 në rrethin e Malësisë së Madhe, 2 në rrethin e Shkodrës, 2 në rrethin e Kolonjës dhe 2 njësive vendore në rrethin e Tropojës.

“Udhëzuesi Metodik i Planifikimit të Zhvillimit Lokal me Pjesëmarrje” është përgatitur duke marrë parasysh praktikat më të mira dhe metodologjitë e ndjekura nga ofrues të këtij shërbimi, në kuadër të mbështetjeve të iniciuara nga MADA në komunat e përmendura më sipër, si dhe në praktikat dhe përvojat e tjera që ekzistojnë brenda vendit dhe në rajon¹.

Nga pikëpamja metodike, përgatitja e këtij dokumenti është mbështetur në identifikimin e metodologjisë më të përshtatshme për procesin e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal; mbajtjen parasysh të aspekteve praktike të domosdoshme për procesin; përcaktimin e hapave për zbatimin e Planit të Zhvillimit Lokal, etj.

1) Dokumentet kryesore metodike mbi të cilat është mbështetur hartimi i këtij udhëzuesi janë përgatitur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (ADF), Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (LGI), Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave (DELTA), Banka Botërore, USAID, etj.



KAPITULLI I

Metodologjia e planifikimit të zhvillimit lokal

1. Qëllimi dhe Rëndësia e Udhëzuesit Metodik për Hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal me Pjesëmarrje

1.1 Disa Përkufizime dhe Terma të Zhvillimit Lokal

Zhvillimi lokal është një përfaqëse lokale e parë si partneritet dhe e planifikuar në mënyrë strategjike me qëllim mundësimin e rritjes së punësimit, uljen e varfërisë dhe rritjen e cilësisë së jetës nëpërmjet përmirësimit të qeverisjes lokale në fushën e ekonomisë (*Sipas Agjencisë Zvicerane për Zhvillimin dhe Bashkëpunimit*).

Nëpërmjet zhvillimit ekonomik lokal, njerëzit punojnë bashkë, me ndihmën dhe lehtësirat e ofruara nga qeverisja lokale dhe nga të tjerë të interesuar të jashtëm, për të siguruar rritje të qëndrueshme ekonomike dhe zhvillim, i cili do të sjellë përmirësim të jetës së secilit (*Udhëzues mbi Politikën për zbatimin e planit të zhvillimit ekonomik lokal, sipas Departamentit të Provincave dhe Qeverisjes Lokale, Afrika e Jugut*).

Qëllimi i Zhvillimit Lokal për ECOLOC është të shpejtojë tranzicionin nga një ekonomi informale e tregut në një ekonomi formale. Kjo arrihet nëpërmjet një analize kuptimplotë, krijimit të një vizioni, planifikimit të kujdesëshëm strategjik si dhe mobilizimit të burimeve. Zhvillimi ekonomik lokal drejtohet nga qeverisja lokale në partneritet me sektorin privat dhe me komunitetin (*Sipas Partneritetit për Zhvillimin e Komunës/Libri ECOLOG Volumi 2*).

Disa terma specifike që lidhen me zhvillimin lokal janë:

Dokumente planifikuese: Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit, Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal, Strategjitë e Zhvillimit Sektorial, Strategjitë e Zhvillimit të

2) http://www.dplg.gov.za/documents/generaldocument/LED_Guidelines_March_2005.pdf

Qarqeve dhe dokumentet përkatëse të zbatimit të tyre (planet e veprimit, etj).

Ekonomia: një koncept i drejtuar ndaj identifikimit të mundësive për investim, mbështetje të aktiviteteve sipërmarrëse dhe lehtësim të aksesit në tregje (të reja).

Forumi ekonomik lokal: një mekanizëm koordinues i vendosur për arritjen e riorganizimit dhe përmirësimit të shpërndarjes së shërbimeve lokale ekonomike.

Indikatorët: matje të përafërta për të ofruar përcaktime operacionale ndaj komponentëve shumëdimensionale të zhvillimit ekonomik lokal. Indikatorët pritet të shërbejnë në funksion të identifikimit të problemeve dhe në formulimin e politikave përkatëse. Ata duhet të mundësojnë një bazë për diskutime dhe planifikim politikash.

Informacion mbi tregun e punës: tërësia e të dhënave të disponueshme mbi një treg pune të caktuar, duke përfshirë statistikat e punësimit dhe të papunësisë, statistikat e zënies me punë dhe të dhëna për mesataren e orëve të punës dhe të pagesave.

Infrastruktura “hard”: ajo përfshin të gjitha asetet fizike të prekshme që kontribuojnë në ekonominë e një njësie administrative si komunë, bashki, etj. Për shembull, infrastruktura e transportit (rrugë, porte, hekurudha, aeroporte), ndërtesa industriale dhe tregtare, ujë, energji, telekomunikacion, vend grumbullimesh, etj.

Infrastruktura e “Butë” (Soft): lidhet me aspektet më pak të prekshme të zhvillimit ekonomik lokal siç është sigurimi i arsimimit dhe trajnimit, cilësia e infrastrukturës së jetesës siç është një park, ambientet shlodhëse dhe shërbimet e bibliotekës, banimi, mbështetje ndaj bizneseve, rrjetëzimi i tyre dhe financimi i shërbimeve, etj.

Inkubatorët e Biznesit: inkubatori i biznesit është një instrument i zhvillimit ekonomik i hartuar kryesisht për të ndihmuar në krijimin dhe rritjen e bizneseve të reja në një komunitet brenda një godine apo vendndodhje të veçantë. Inkubatorët e biznesit ndihmojnë bizneset e reja duke iu ofruar shërbime asistencë të ndryshme, si për shembull: zhvillimi i planeve të biznesit dhe marketingut, ngritja e aftësive menaxheriale, sigurimi i kapitalit dhe aksesit ndaj shërbimeve më të specializuara. Gjithashtu, ato ofrojnë hapësira fleksibile për qira, pajisje dhe shërbime administrative për menaxhimin e vendit të punës.

Mbështetje për të filluar një biznes: suporti ndaj biznesit përfshin një gamë të gjerë të shërbimeve që aftëson ato njerëz që hapin biznes për herë të parë. Iniciativat përfshijnë: trajnim, këshillim, ndërtim rrjetesh për bashkëpunim, udhëheqje dhe asistencë financiare (grante, kredi, subvencione me norma të favorshme interesi, të cilat janë metodat më tradicionale; ndërkohë që ofrohen dhe metoda më novatore për të mbështetur financiarisht ata duke u përpjekur për të tërhequr më shumë investime në sektorin privat se sa në atë publik).

Një Ndalesë! (qendrat e shërbimit “One Stop Shop” ndaj biznesit): janë mjedise ku personat që merren me biznes mund të shkojnë për të marrë këshilla dhe asistencë për t’i ndihmuar në

ngritjen e një biznesi dhe zgjerimin e tij. Ndonjëherë këto qendra lëshojnë edhe licenca dhe leje të domosdoshme për të filluar bizneset, për të vepruar apo për t'i zgjeruar ato. Këto qendra përmirësojnë klimën lokale të biznesit, duke reduktuar numrin e agjencive dhe të zyrave të veçanta dhe ofrojnë këshillim për bizneset që mund të kenë nevojë për licenca dhe leje të ndryshme. Ato kursejnë kohën publike dhe private dhe përmirësojnë efikasitetin duke dhënë rezultate konkrete.

Partneritet privat/publik: bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarive të ndryshme zhvillimore i frenon aktorët nga një përjasje joefektive nisur nga baza individuale duke mbështetur legjitimitetin dhe qëndrueshmërinë e procesit të zhvillimit. Zhvillimi ekonomik lokal është një mjet për të arritur mobilizimin efektiv të burimeve lokale nëpërmjet inkurajimit të investimeve me shkallën më të lartë të kompensimit social-ekonomik. Partneriteti ndërmjet privatit - publikut dhe aktorëve jo-fitimprurës bëhet i rëndësishëm për një proces zhvillimi të qëndrueshëm duke lejuar konvergencën në programimin e investimeve ndërmjet aktorëve të ndryshëm lokal.

Projekt zhvillimi: është një projekt ndërtimi dhe/ose rindërtimi i infrastrukturës së shërbimeve, ekonomike dhe infrastrukturave të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm; e ndërtimit dhe/ose fuqizimit (forcimit) të institucioneve arsimore, kulturore, shkencore dhe të tjera; e forcimit dhe krijimit të kapitalit social, si dhe çdo projekt ekonomik tjetër që mund të kontribuojë në zhvillimin rajonal.

Rajon: do të nënkuptohet një tërësi territoriale në vazhdimësi, që përfshin një numër njësisish administrative territoriale të qeverisjes vendore.

Rrjet Furnizimi: produktet dhe proceset që janë thelbësore për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve. Strategjitë e integruara të zhvillimit ekonomik lokal inkurajojnë mbylljen e ciklit të biznesit në fushën e tyre të veprimtarisë. Kjo mbasi mbyllja e ciklit të biznesit, shihet në funksion të shtimit të vlerës së të gjithë hallkave të biznesit të marra sëbashku.

Spektori informal: nuk është sektor ligjor dhe formal dhe për këtë arsye nuk i ofrohen shërbime për t'u zhvilluar. Spektori informal nuk është i aftë të përdorë asetet si kolateral për investime të reja prodhuese.

Shërbime të zhvillimit të eksportit: programet e asistencës ndaj eksportit mund t'i ndihmojnë bizneset të zgjerojnë numrin e blerësve, të rrisin dhe të zhvillojnë aktivitetet dhe të bëhen më përfitues. Shërbimet e eksportit përfshijnë: vlerësimin e aftësive të kompanisë për eksport, studim tregu, shërbime informacioni (mbi eksportin, transportin, etj); veprimtari promovuese e marketingu.

SME-të: ky është shkurtime për "Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme". Nuk ka një përcaktim të saktë të dallimit ndërmjet një biznesi të vogël dhe të mesëm. Si një referencë e përgjithshme, biznes i vogël merret biznesi me 5 deri 20 punonjës, i mesëm me 20 deri në 200. Bizneset me më pak se 5 punonjës janë zakonisht quhen mikro-ndërmarrje.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritimit: nënkupton një paketë integrale dhe të bashkërenduar objektivash, prioritetesh, veprimtarish dhe masash të orientuara drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm, social dhe ekonomik të Republikës së Shqipërisë.

Trajnim sipërmarrës: programe që ofrojnë udhëzime dhe instruksione për bazat e biznesit (siç është mbajtja e llogaritjeve dhe marketingu) në mënyrë që biznesi të përmirësojë shanset për sukses.

Vendim-marrja me pjesëmarrje dhe dialogu social: përfshirja e aktorëve lokalë në procesin e zhvillimit të territorit të tyre është një parakusht për rritje të qëndrueshme. Organizimi i aktorëve lokalë në një tavolinë të përbashkët pune nëpërmjet një Forumi Lokal ndihmon në ndërtimin e besimit, inkurajon ide të reja dhe promovon krijimin e rrjeteve dhe të veprimtarive sociale. Dialogu social, ndihmon në përfshirjen e aktorëve lokalë duke përforcuar kohezionin social, si rrjedhim ul rrisqet për konflikte.

Zhvillimi: është një proces që ka për synim të promovojë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të vendit të punës në një komunitet, nëpërmjet krijimit të vendeve të punës, vazhdimësinë e vendeve të punës ekzistuese dhe gjenerimit të të ardhurave.

Zhvillimi rajonal: është një proces afatgjatë i rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik që arrihet nëpërmjet identifikimit, stimulimit dhe menaxhimit të potencialit zhvillimor të rajoneve të veçanta.

1.2 Çfarë është Zhvillimi Lokal?

Zhvillimi lokal është një proces i planifikimit strategjik nëpërmjet partneriteteve ndërmjet qeverisë lokale, komunitetit të biznesit dhe Organizatave Jo-Fitimprurëse (OJF). Objektivi i tij është stimulimi i investimeve, të cilat promovojnë rritje të lartë e të qëndrueshme në një komunitet lokal. Zhvillimi ekonomik lokal përqëndrohet në potencialet e rajonit dhe identifikon në mënyrë specifike se çfarë mund të bëjnë partnerët lokalë dhe çfarë është e nevojshme për të siguruar që komuniteti i tyre lokal të arrijë potencialet e veta. Në këtë kontekst, zhvillimi lokal vlerëson avantazhet krahasuese të komunitetit, identifikon tregje të reja ose ekzistuese, redukton pengesat për zgjerim të biznesit apo ngritjen e bizneseve të reja. Veprimtaritë e zhvillimit lokal duhet të kenë një impakt në aftësinë ekonomike të të gjithë qendrës së banuar dhe territorit përreth, jo vetëm në një sektor të veçantë të ekonomisë lokale. Në këtë mënyrë, zhvillimi lokal mund të përkufizohet si një proces shumëdimensional që synon në përmirësimin e jetës së qytetarëve nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve lokale dhe përdorimit efektiv të kapaciteteve organizative: administrimit, menaxhimit, planifikimit dhe shërbimeve të tjera që prodhojnë "të mira" publike lokale (p.sh. vende të reja pune), maksimizojnë potencialin ekonomik, mbështesin iniciativën e lirë private dhe ofrojnë shërbime publike më cilësore për qytetarët.

Qëllimi i zhvillimit lokal është të ndërtojë kapacitetin e një zone lokale për të përmirësuar ekonominë në të ardhmen dhe cilësinë e jetesës për të gjithë. Planifikimi gjithëpërfshirës i zhvillimit ekonomik identifikon lidhjen midis cilësisë së jetesës dhe zhvillimit ekonomik. Kjo nxit rritje të re dhe zhvillon komunitetin drejt përmirësimit të gjithanshëm.

Planifikimi i zhvillimit lokal është procesi nëpërmjet të cilit një komunitet organizon, analizon,

planifikon dhe më pas aplikon energjitë e tij për të përmirësuar mirëqenien ekonomike dhe cilësinë e jetesës për anëtarët e komunitetit. Siç dihet, zhvillimi i ekonomisë përgjithësisht ka natyrë ciklike, duke u bazuar në kombinimin e faktorëve, përfshirë ciklet prodhuese, aplikimet e teknologjisë, ndërhyrjet e qeverisë dhe një sërë indikatorësh të tjerë. Për këtë arsye, zhvillimi në një komunitet do të ndodhë pavarësisht nëse planifikohet apo jo; komuniteti do të pësojë ndryshime ekonomike pavarësisht nëse janë ndryshime të dëshiruara. Avantazhi në planifikimin gjithëpërfshirës është që komunitetet mund të parashikojnë këto ndryshime dhe të drejtojnë zhvillimin drejt kapaciteteve dhe aftësive më të mira. Si rrjedhim, secili plan do të jetë unik dhe i hartuar për nevojat dhe dëshirat e çdo komuniteti.

Në literaturën e sotme njihen një seri planesh të zhvillimit lokal, por komunitete të suksesshme kanë prirjen të kenë një tipar të përbashkët, një vizion të përbashkët të artikuluar se ku duan të arrijnë dhe se çfarë vlen në komunitetin e tyre. Planet e tyre për zhvillim lokal ndajnë pikërisht këto vlera.

1.3 Çfarë është Plani i Zhvillimit Lokal?

Një vizion i përbashkët

Komunitetet rurale shqiptare përballen me shumë sfida në zhvillim dhe me mungesë burimesh për t'u dhënë zgjidhje atyre, por ekzistojnë gjithashtu dhe shumë mundësi. Detyra është t'i bashkoh këto mundësi dhe vullnetin e komunitetit në një vizion të përbashkët drejt të cilit ato mund të identifikojnë dhe të përdorin burime njerëzore, natyrore dhe financiare sa më me efikasitet në dobi të tyre. Këto veprimtari çojnë në krijimin e "Vizionit të Komunitetit".

Një plan për të Ardhmen

E ardhmja e çdo komuniteti pa dyshim që ndryshon dhe qeverisjet lokale duhet të sigurojnë se ato, duke përdorur zërin e komunitetit, janë autorët e këtij ndryshimi duke mos ia lënë rastësisë dhe rrethanave, të ndërtojnë të ardhmen e tyre. Planifikimi i zhvillimit lokal përmban qëllime të arritshme dhe hapa veprimi, të cilat janë të mundshme gradualisht drejt rrugës së arritjes së "Vizionit të Komunitetit".

1.4 Pse është i Rëndësishëm Zhvillimi Ekonomik Lokal?

Arsyet janë krejtësisht themelore: zhvillimi lokal ndihmon për të "paguar faturat". Zhvillimi është të punuarit sëbashku për të ruajtur një ekonomi të fortë duke krijuar dhe duke mbajtur vende pune të dëshirueshme, të cilat mundësojnë një standard të mirë jetese për individët. Të ardhurat personale të shtuara dhe mirëqenia rritin bazën e taksave, ndaj një komunitet, rajon apo shtet mund të ofrojë në këtë mënyrë shërbime më të mira siç presin qytetarët prej tyre. Një ekonomi e balancuar dhe e shëndetshme është thelbësore për mirëqenien e komunitetit. Shpenzimet e zhvillimit të ekonomisë janë një investim i komunitetit. Ndikimi dhe investimi në

procesin e zhvillimit ekonomik i lejon komunitetit të përcaktojë drejtimet e tij të ardhshme dhe të orientojë tipet e duhura të zhvillimit në përputhje me vlerën e vet. Shumë komunitete dhe rajone angazhojnë operatorë ekonomikë, misioni i të cilëve është të mbajnë dhe përforcojnë vitalitetin ekonomik të bazuar në vlerat e komunitetit.

Një planifikim efektiv i zhvillimit lokal kërkon që pushteti lokal të kuptojë se me çfarë "biznesi" merret, kush janë klientët e tij dhe sa mirë po i plotëson ai nevojat dhe pritshmëritë e tyre. Kur realizohet mirë, planifikimi i zhvillimit lokal përfshin kontribute dhe pjesëmarrje nga një segment i konsiderueshëm i komunitetit dhe aktorëve të tjerë. Kjo garanton që qeverisja lokale të kombinojë burimet më të mira të mundshme gjatë planifikimit të së ardhmes së tij si dhe të realizojë një forum kyç për pjesëmarrjen dhe angazhimin e shoqërisë civile.

Planifikimi i Zhvillimit Lokal i lejon gjithashtu pushtetit lokal të bashkërendojë më mirë shërbimet e tij me përparësitë e këshillit dhe komunitetit lokal si dhe me përparësitë në nivel qarku dhe në atë kombëtar. Nga ana tjetër institucionet e qarkut dhe ato kombëtare si dhe donatorët kanë se çfarë të mësojnë dhe të përfitojnë nga planet e zhvillimit lokal në lidhje me përcaktimin e kornizave më të gjera në hartimin e politikave dhe plan-veprimeve.

Një Plan i Zhvillimit Lokal është efektiv vetëm atëherë kur përdoret në mënyrë rigorozë për qëllime të planifikimit dhe të hartimit të shërbimeve dhe të projekteve, shpërndarjes së burimeve, identifikimit të boshllëqeve dhe të nevojave fiskale, matjes së rezultateve të punës së qeverisjes lokale dhe komunikimit të këtyre rezultateve të komuniteti. Në këtë mënyrë ai është një proces dhe një dokument nëpërmjet të cilit komuniteti mund t'u kërkojë llogari drejtuesve të tij të zgjedhur apo të emëruar për realizimin e detyrave në një mënyrë të tillë që t'iu përgjigjet nevojave dhe përparësive të veta. Ai siguron një përdorim me vend dhe efektiv të burimeve të kufizuara për të siguruar që komuniteti është pozicionuar në mbështetje të arritjes së qëllimeve të planit të zhvillimit lokal.

Në aspektin konceptual, Plani i Zhvillimit Lokal duhet të mbrohet dhe të aprovohet nga Këshilli Komunal. Megjithëse në parim Plani i Zhvillimit Lokal ka karakter afatgjatë si nga vizioni ashtu edhe nga veprimet, përsëri është e nevojshme që të ketë një shkallë të lartë fleksibiliteti për të siguruar përshtatshmëri dhe përgjegjshmëri të vazhdueshme ndaj nevojave dhe përparësive në ndryshim të komunitetit. Në këtë mënyrë Plani i Zhvillimit Lokal duhet të rishikohet çdo vit dhe të ndryshohet sa herë të jetë e nevojshme.

Plani i Zhvillimit Lokal është një proces që u jep mundësinë komunave të planifikojnë, të zbatojnë dhe të kontrollojnë të ardhmen e tyre. Një Plan Zhvillimi Lokal jep informacion mbi drejtimin e veprimeve në funksion të zhvillimit të një komuniteti. Në këtë mënyrë, Plani i Zhvillimit Lokal është një "hartë" për t'u ndjekur nga të zgjedhurit, personeli i komunës dhe komuniteti në tërësi, për t'i dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. D.m.th. Plani i Zhvillimit Lokal ka të bëjë me të menduarit, të vepruarit dhe të parashikuarit strategjik të veprimeve që duhen ndërmarrë në mënyrë që të realizohen qëllimet e dëshiruara.

3) Për më shumë hollësi, shih Pasqyrën Aneks #1 në fund të Udhëzuesit

1.5 Pse Shërben Plani për Zhvillimin Lokal?

Plani për Zhvillimin Lokal realizon tre qëllime kryesore:

Së pari, shërben si një mjet komunikimi për të ndarë vizionin për zhvillimin e komunës së bashku me të gjithë pjesëtarët e komunitetit, sektorin privat dhe administratën publike qendrore dhe lokale;

Së dyti, shërben si një udhërrëfyes për hartuesit e politikave dhe të gjithë grupet e interesit që operojnë në fushën e zhvillimit ekonomik që vendimet të cilat prekin sfidat e sotme të udhëhiqen nga një vizion i qartë;

Së treti, siguron një skelet të fortë e të harmonizuar për planifikimin afatgjatë të aktiviteteve të Komunës.

1.6 Qëllimi i Udhëzuesit Metodik

Objektivi kryesor i veprimtarisë së MADA-s është të përforcojë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe promovojë përdorimin eficient të burimeve sociale dhe natyrore në këto zona. Këto objektiva arrihen nëpërmjet tre komponentëve kryesorë të veprimit, përkatësisht:

- (i) promovim të një kuadri funksional institucional dhe financiar për zhvillimin e sektorit privat,
- (ii) promovim të një shpërndarjeje të përshtatshme të fondeve të investimeve publike për zbatimin e duhur të infrastrukturës sociale dhe ekonomike dhe ruajtjen e mjedisit,

si dhe

- (iii) ngritje të kapaciteteve të qeverisjes lokale dhe të komuniteteve lokale.

Nëpërmjet këtij Udhëzuesi, MADA mbështet një proces pjesëmarrës të bazuar në partneritetin e aktorëve të ndryshëm (publikë, privatë, komunitete, veprimtarë civilë dhe lider në biznes) për të krijuar një vizion strategjik dhe plane veprimi të përshtatshme (brenda një ekonomie rajonale) që kur të vihen në jetë të japin rezultate në krijimin/ruajtjen e vendeve të punës.

Reduktimi i varfërisë mund të jetë një qëllim tjetër i programeve të zhvillimit lokal. Përveç zonave rurale, pjesa më e madhe e popullsisë së punësuar dhe në kufijtë e varfërisë punojnë në sektorin informal dhe në biznese të vogla. Disa banorë të zonave rurale punojnë në një sektor informal biznesesh me paga të ulëta, por ata janë gjithmonë të pasigurt për vendin e punës, të fundit që punësohen dhe të parët që mund të pushohen nga puna dhe si rezultat janë më të prekshëm ndaj rënies së ekonomisë lokale. Kështu, që përdorimi i planeve të zhvillimit lokal për të integruar më mirë atë shtresë të varfër dhe bizneset e tyre në ekonominë lokale, vlerësohet se mund të japë më shumë rezultate në reduktimin e varfërisë se sa programet e ndihmës sociale që janë financiarisht të vështira për t'u mbajtur. Në nivel lokal bizneset e sektorit formal kërkojnë një rrjet furnizimi për mallrat dhe shërbimet. Shkalla nëpërmjet të cilit mikro-bizneset dhe ato informale të shtresës më

të varfër mund të lidhen me bizneset e sektorit formal nëpërmjet rrjeteve të tyre të furnizimit do të përcaktojë shkallën të cilën të varfërit mund të përfitojnë nga zhvillimi i ekonomisë lokale.

“Udhëzuesi Metodik” synon të ndihmojë në përgatitjen e planeve të zhvillimit lokal në nivel komune. Dokumenti është hartuar për strukturimin e dialogut ndërmjet stafit administrativ e atij profesional që do të përfshihet në formulimin dhe zbatimin e planit të zhvillimit lokal, të cilët rrjedhimisht mund të përfshihen në zhvillimin e mëtejshëm të planeve vendore hapësinore, planeve të veprimit dhe atyre sektoriale. Ai mund të shërbejë edhe në mënyrë më specifike, si një dokument për të integruar këndvështrimet e anëtarëve të grupit të punës për hartimin e këtij plani. E veçanta e këtij procesi është se me dokumentin “Udhëzuesi Metodik i Planit të Zhvillimit Lokal me Pjesëmarrje” ju krijohen mundësitë të gjithëve, por posaçërisht stafeve të komunave, për të punuar në mënyrë të pavarur në këtë proces.

2. Përmbajtja e Planit të Zhvillimit Lokal

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces jetësor që i jep mundësinë qeverisjes lokale dhe publikut që ai përfaqëson, të marrë kontrollin dhe t'i japë formë të ardhmes së tyre. Një plan zhvillimi siguron informacion mbi dinamikën e zhvillimeve të një komuniteti, një “hartë rrugore” nëse mund të thuhet kështu, për t'u ndjekur nga zyrtarët e zgjedhur, stafi i pushtetit lokal dhe komuniteti në dhënien formë të së ardhmes tyre të dëshiruar.

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces aktiv. Ai ka të bëjë me të planifikuarit, menduarit, parashikuarit strategjik të zhvillimeve që një komunitet ka nevojë të bëjë me qëllim që të arrijë synimet e dëshiruara.

Hartimi i planeve të zhvillimit të nivelit komunal, është faktor që ndikon në zhvillim të qëndrueshëm të komunës, i cili duke u bazuar në shfrytëzim efikas të burimeve natyrore, ruajtje dhe zhvillim të trashëgimisë kulturore, zhvillim optimal të infrastrukturës, rezulton në krijimin e qendrave të banuara rurale sipas standardeve bashkëkohore, me mjedis të pastër dhe të shëndoshë për jetesën e banorëve.

Në mënyrë të përgjithshme, plani i zhvillimit lokal përmban katër pjesë kryesore:

- Pjesa e parë paraqet qëllimin dhe kontekstin në të cilin hartohet plani i zhvillimit lokal si dhe procesin organizativ dhe institucional që shoqëron formulimin e këtij plani;
- Pjesa e dytë ilustron stadin aktual të zhvillimit ekonomik dhe të faktorëve dhe aktorëve që influencojnë procesin e zhvillimit ekonomik;
- Pjesa e tretë përshkruan vizionin për zhvillimin e komunës, qëllimet dhe objektivat strategjike që prekin fushën ekonomike dhe kontributin e qëllimeve strategjike në funksion të vizionit të komunës, dhe
- Pjesa e katërt përmban përmbledhje dokumentesh kryesore dhe procesin që kanë udhëhequr dhe shoqëruar hartimin e planit të zhvillimit ekonomik të komunës.

2.1 Komponentët, Prioritetet dhe Parimet Kryesore të Hartimit të Planit

Në këndvështrimin e hartimit dhe të zbatimit të Planit të Zhvillimit Lokal, njihen pesë komponentë të përgjithshëm, të cilët influencojnë në cilësinë dhe efektivitetin e zhvillimit ekonomik. Këto komponentë janë të shpjguara më poshtë.

2.1.1 Pesë komponentët kryesor të strategjisë³

- a) Strategjia e zhvillimit të biznesit - fokusohet në ruajtjen dhe zgjerimin e biznesit, zhvillimin e biznesit të vogël dhe rrjeteve të furnizimit.
- b) Strategjia e rihvillimit të komunitetit që do të përqëndrohet në rinovimin e qendrës së banimit, rihvillimin e vijës ujore, rihvillimin e kullotave, rihvillimin e periferisë dhe përmirësimin e zonave të biznesit.
- c) Strategjia e zhvillimit të fuqisë punëtore e përbërë nga një strategji e migracionit, arsimimit dhe ngritjes së kapaciteteve për zhvillimin e bujqësisë dhe agro-industrisë në një ekosistem novativ.
- d) Infrastruktura për planet e novacionit përfshin tokat e punëshme, mbështetje për studime dhe anketime, etj.
- e) Cilësia e jetës - tërheqja e njerëzve dhe cilësia e jetesës përfshin artin, kulturën, traditën, mjedisin, strehimin, kujdesin shëndetësor, etj.

2.1.2 Katër Prioritetet e Zhvillimit Lokal

Metodologjia e MADA-s për hartimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit lokal synon përfshirjen e një rrjeti të gjerë aktorësh lokalë me synim mbulimin e përparësive të zhvillimit në secilin komunë në veçanti. Të gjithë objektivat strategjike dhe hapat e veprimit janë në këtë mënyrë të organizuar sipas katër fushave të përparësive të mëposhtme:

- **Zhvillimi Ekonomik:** bizneset e vogla dhe të mesme, bujqësi, blegtori, pylltari, bletari, agro-industri, tregti, turizëm dhe shërbime të tjera.
- **Zhvillimi Social:** shëndetësi, arsimim, shërbime për të rinj dhe të rritur, mirëqenie sociale dhe ndihmë sociale.
- **Infrastrukturë Publike dhe Shërbime:** rrugë, ujë dhe kanalizime, shërbime pastrimi, mbledhje mbeturinash, shkolla dhe shërbimi shëndetësor.
- **“Qeverisje e Mirë”:** përgjegjësi, gjithëpërfshirje, informim publik, besim ndaj institucioneve, shërbime ndaj komunitetit, menaxhim efektiv i shërbimeve, zhvillim organizativ për të arritur qëllimet strategjike.

Për secilin komponent njihen një sërë strategjish për të përmbushur objektivat dhe qëllimet e

zgjedhura të komunitetit. Për shembull, zhvillimi i biznesit mund të arrihet nëpërmjet nxitjes së biznesit, ruajtjen e qëndrueshmërisë së biznesit dhe zgjerimin e tij, apo inkurajimin për sipërmarrje të grupeve të caktuara shoqërore (p.sh. të rinjtë, etj).

Duke qenë se zhvillimi ekonomik është bërë më i kuptueshëm dhe i ngulitur në ndërgjegjen e publikut, strategjitë për zbatimin e planeve të zhvillimit ekonomik gjithmonë e më shumë po tregojnë se duhen rishikuar në përputhje me konceptet dhe standardet e sotme. Konceptet e zgjedhura nga komunitetet bazohen në një gjykim real me vlerë për të drejtuar zhvillimin ekonomik. Prandaj është e domosdoshme për komunitetet të gjejnë kohën dhe të bëjnë përpjekje për të vendosur një vizion dhe plan që të reflektojë vlerat e tyre. Vënia në jetë e tyre është po ashtu një element i kërkuar i procesit të Planit të Zhvillimit Lokal.

2.1.3 Parimet kryesore për hartimin e Udhëzuesit Metodik

Parimet kryesore ku mbështetet Udhëzuesi për hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal janë:

- a) Për një zhvillim lokal të suksesshëm, duhet që të bazohemi në një planifikim strategjik efektiv.
- b) Bashkëpunimi dhe diskutimi i gjerë i publikut janë kryesore për një plan lokal të mirë.
- c) Planifikimi është një proces integruar dhe duhet të ndërtohet apo të marrë parasysh aktivitete të tjera planifikuese të lidhura me shërbimet në një zonë të caktuar për zhvillim të mëtejshëm ekonomik, siç është transporti, arsimi, mbrojtja e mjedisit, shmangia e fatkeqësive natyrore dhe mirëpërdorimi i burimeve në dispozicion.
- d) Procesi i planifikimit është mjeti nëpërmjet të cilit përcaktohen përparësitë e zhvillimit lokal. Si rezultat këto përparësi do të japin produktet e tyre në zbatim të strategjive të përgjithshme, programeve dhe performancën e objektivave.
- e) Zhvillimi ekonomik është i lidhur ngushtë me çështje të barazisë gjinore dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- f) Procesi i planifikimit duhet të drejtojë, të gjenerojë dhe të mbështesë një sërë aktivitete të zhvillimit ekonomik që adresojnë një seri burimesh të fondeve private dhe shtetërore.
- g) Procesi i planifikimit duhet të jetë një mjet i fuqishëm për promovimin e bashkëpunimit ndër-komunal, në nivel qarku e më gjerë, si dhe për ngritjen e kapaciteteve në institucionet/organizatat e zhvillimit ekonomik rajonal.
- h) I duhet dhënë prioritet më shumë për caktimin e matësve të performancës dhe standardizimit në mënyrë që të vlerësohet progresi kundrejt qëllimeve të planifikuara dhe të parashikohen përditësime të planit dhe rregullime të tij.

3. Aktorët Pjesëmarrës në Përgatitjen e Planit të Zhvillimit Lokal

3.1 Qëllimi kryesor i veprimtarisë së MADA


Si pjesë e metodës së MADA-s për hartimin e Udhëzuesve për hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal, mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale përfshin mbështetjen për disa këshilla komunale në aspektet e planifikimit strategjik në nivel lokal.

3.2 Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (Grupi PZhL)

Grupi PZhL-së është përgjegjës për udhëheqjen, për të dhënë direktiva dhe këshilla dhe për të mbikëqyrur zhvillimin e Planit të Zhvillimit Lokal. Grupi PZhL-së përbëhet nga përfaqësues të Këshillit Komunal, administratës lokale, pleqësive të fshatrave dhe komunitetit të gjerë. Ai ndahet në disa nën-grupe – për të patur një efektshmëri logjistike dhe thelbësore. Ndërmjet tyre janë:

- Drejtuesi, zgjidhet nga Grupi PZhL-së (si rregull ai është Kryetari i Komunës)
- 2-3 anëtarë të Këshillit
- 3-5 persona nga stafi i Komunës (p.sh. nga urbanistika, financa, shërbimet publike, shërbimet sociale)
- 3-5 qytetarë të zakonshëm të cilët të përfaqësojnë karakteristika demografike/profesionale të ndryshme të popullsisë
- 1 përfaqësues nga çdo fshat

Figure 1: Model i Strukturës së Brendshme të Grupit PZHL



3.3 Nën-grupi i Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje (MVP)

Nën-grupi MVP ngarkohet me përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e procesit të PZHL-së duke asistuar në identifikimin e mënyrës së matjes së rezultateve për synimet strategjike dhe hapat e veprimit, si dhe në vlerësimin e arritjes së rezultateve. Me përfundimin e planit dhe aprovimin e tij nga Këshilli, nën-grupi MVP zgjerohet dhe kryen një monitorim të vazhdueshëm të rezultateve të PZHL-së.

3.4 Nën-Grupi për Zonat Prioritare

Këto nën-komisione të Grupit PZHL përfaqësojnë ato që quhen katër kolonat ku mbështetet vetë PZHL-ja (*zhvillimin ekonomik, zhvillimin social, infrastrukturën publike dhe shërbimet e mirë-qeverisjes*) dhe janë përgjegjëse për specifikimin e hapave/projekteve të veprimit për zonat prioritare si dhe për kryerjen e para-studimeve të fizibilitetit të planeve të veprimit. Duke qenë të përbërë gjerësisht nga anëtarë të Grupit PZHL këto nën-komisione gjithashtu ftojnë ekspertë lokalë dhe të jashtëm për të siguruar këshillime të mirëpritura mbi zhvillimin e planeve të veprimit.


Nën-grupet e tjera të Grupit PZHL të cilat parashikohet të sigurojnë një aplikim sa më efektiv të metodologjisë, janë: *nën-grupi i Mobilizimit të Komunitetit, nën-grupi i Grumbullimit të Dhënave dhe një Sekretariat për grumbullimin dhe mirëmbajtjen e gjithë këtyre materialeve.*

3.5 Si duhet të jenë të organizuara dhe drejtuara politikat e zhvillimit lokal? Cilat grupe duhet të përfshihen?

Politikat e zhvillimit lokal duhet të jenë të koordinuara, dhe akoma më mirë të organizuara brenda një zone të tregut lokal të punës (siç është qarku) për disa arsye që lidhen me konkurrencën, dinamikën e tregut të punës, etj. Ndërkaq një program i zhvillimit ekonomik duhet të ketë komunikim dhe koordinim të mirë ndërmjet një varieteti të gjerë grupesh në një zonë tregu pune. Siç dihet, programet e zhvillimit ekonomik lokal ndërmerren nga qeverisjet vendore, agjencitë shtetërore të zhvillimit ekonomik, qendrat e zhvillimit të biznesit të vogël, organizata që ofrojnë biznes apo shërbime të ekstensionit, përpjekje të universiteteve për transferimin e njohurive, programe trajnimi, dhomat e tregtisë, kompani utilitare dhe një gamë e gjerë me organizata të pavarura jo fitimprurëse.

Studime të ndryshme evidentojnë avantazhet, ashtu siç paraqesin edhe risqet përkatëse në ushtrimin e zhvillimit ekonomik lokal me përfshirjen e sektorit privat. Kjo mund të jetë në formën e partneritetit formal publik–privat që administron disa programe apo përpiket të koordinojë programe, një partneritet formal publik – privat që zbaton një projekt të veçantë, apo një formë bashkëpunimi jozyrtar publik–privat. Sektori privat mund të ofrojë fonde shtesë për zhvillimin ekonomik lokal. Ai mundet që ndonjëherë të jetë më fleksibel në ato që mund të bëjë.

Figurë 2: Struktura e Procesit të PPlanifikimit të Zhvillimit Lokal



Zhvillimi ekonomik nuk ndodh në boshllëk. Për të qenë i suksesshëm, zhvillimi ekonomik duhet të funksionojë si pjesë e tërë mjedisit social-ekonomik. Ky mjedis është në mënyrë konstante në ndryshim. Megjithatë, komponentët bazë të këtij mjedisi mund të përgjithësohen. Sipas eksperiencës së derisotme të MADA-s, një kuadër gjithëpërfshirës i zhvillimit ekonomik "ka të bëjë në thelb me përforsimin e faktorëve të kapacitetit prodhues: tokë, punë, kapital dhe teknologji të një kombi, shteti apo ekonomie lokale"... në zhvillimin ekonomik. Në vijim (Figura 2) jepet një strukturë e përmbajtjes së procesit të planifikimit të zhvillimit lokal.

Plani i Zhvillimit Lokal zakonisht rishikohet një herë në vit nga grupi i PZHL, stafi i qeverisjes vendore dhe zyrtarë të emëruar për të vlerësuar procesin dhe impaktet e përgjithshme të tij. Gjithashtu, ai shpesh përdoret edhe si mjet planifikimi për të ndihmuar vendimmarrjen mbi shpërndarjen e burimeve në dispozicion.

3.6 Planifikim Strategjik për Zhvillimin Lokal

Planifikimi strategjik është një proces i mirëorganizuar që i lejon banorëve të zonave rurale të identifikojnë dhe adresojnë çështjet me rëndësi brenda komunitetit të tyre. Kjo metode planifikimi fillon me tre pyetje kryesore:

- Ku ndodhet komuniteti ynë sot?
- Si e duam komunitetin të jetë në të ardhmen?
- Si mund të lëvizim drejt së ardhmes në mënyrë efektive?


Ndërkohë që planifikimi strategjik nuk mund të kurojë të gjithë sëmundjet e komunitetit, ai mund t'i kushtojë vëmendje një sërë çështjesh që duhet të adresohen.

3.7 Nevoja për planifikim strategjik

Në ditët e sotme komunitetet rurale përballen me zgjedhje të vështira, pasi ekonomitë e tyre zhvillohen të varura nga bujqësia dhe industritë bazuar në burime natyrore deri në varësinë prej burimeve më pak tradicionale të të ardhurave dhe punësimit siç është industria e lehtë përpunuese dhe bizneseve të shërbimeve. Përveç këtyre ndryshimeve ekonomike, qeverisja vendore në zonat rurale shpesh e gjen veten në mes të kërkesës në rritje për shërbime qeveritare dhe reduktimit të vazhdueshëm të fondeve shtetërore.

Nëpërmjet vendimeve sipërmarrëse, këto komunitete duhet të krijojnë rrugë të reja për të mundësuar shërbime publike të domosdoshme dhe të sigurojnë një bazë ekonomike të shëndoshë.

Figurë 3: Skema e Procesit të Planifikimit Strategjik



Vendimet sipërmarrëse duhet të bazohen në burime fizike dhe njerëzore të disponueshme për komunitetin, në situatën aktuale dhe të pritshme ekonomike jashtë komunitetit, dhe nevojave të qytetarëve brenda komunitetit. Procesi i planifikimit strategjik mund t'i ndihmojë komunitetet në marrjen e vendimeve të vështira duke ju ofruar një mënyrë të organizuar, ende të ndryshueshme, për të projektuar të ardhmen. Në figurën 3 jepet një skemë e hallkave kryesore të planifikimit strategjik në funksion të zhvillimit lokal.

3.8 Drejtimi i Planifikimit Strategjik

3.8.1 Organizimi dhe sponsorizimi

Elementët kryesorë të planifikimit strategjik përfshijnë pjesëmarrje të gjerë të komunitetit dhe planet për përmirësim të cilat shkrihen si rezultat i këtij procesi. Hapi i parë është ngritja e Komitetit të Planifikimit të përbërë nga 8 në 15 anëtarë të cilët mundësojnë pjesëmarrjen e të gjithë komunitetit. Njësitë e qeverisjes lokale duhet gjithashtu të mbështesin gjerësisht procesin e planifikimit pasi mbështetja e tyre është mjaft e rëndësishme për përkthimin e planeve në veprime konkrete. Në të njëjtën kohë, planifikimi strategjik i zhvillimit lokal duhet të përfshijë njerëz nga grupet e zhvillimit dhe përmirësimit të komunitetit, dhomat e tregtisë, bankat, shoqëritë që ofrojnë shërbimet publike bazë (ujë i pijshëm, energji elektrike, etj.) industri të agro-biznesit, organizaçatë të shoqërisë civile, institucionet fetare dhe arsimore. Pjesëmarrësit në procesin e planifikimit duhet të pasqyrojnë popullsinë e komunitetit me përfaqësues të të dyja gjinive dhe krahinave (rajoneve) gjeografike. Më tej; në proces duhet të marrin pjesë edhe individë të cilët zakonisht nuk janë të përfshirë në aktivitete të planifikimit dhe të promovimit të zhvillimit ekonomik duke marrë role kryesuese. Një larmishmëri e këtij lloji u jep njerëzve mundësi të pasqyrojnë një gamë më të gjerë opinionesh duke identifikuar në mënyrë më efektive nevojat më kritike të komunitetit.

3.8.2 Analiza e mjedisit

Promovimi i zhvillimit ekonomik të komunitetit kërkon perceptimin realist të burimeve të komunitetit, të mundësive për shfrytëzimin e tyre dhe prirjet e ekonomisë kombëtare për të prekur komunitetin në fjalë, si dhe burimet e tij. Një skanim i tille i mjedisit ekonomik e mundëson një perceptim të tillë pasi identifikon pikët e brendshme të forta dhe të dobëta, mundësitë e jashtme dhe rreziqet që kërcënojnë potencialet zhvillimore të komunitetit.

3.8.3 Identifikimi i çështjeve kryesore

Komunitetet duhet të fokusohen në një lloj të caktuar çështjesh. Grupi për Zhvillimin Lokal mund të përcaktojë së çfarë çështjesh janë më kryesore dhe praktike, përmes debateve të organizuara dhe të strukturuar mirë. Shpeshherë, liderët e komunitetit do të konsultohen me liderë të komuniteteve të tjera ose të kryejnë anketime të banorëve të komunitetit për të mësuar opinionin e tyre rreth problemeve me të cilat ata merren.

3.8.4 Zhvillimi i objektivave dhe strategjitë e rekomanduara

Pas përzgjedhjes së çështjeve, Grupi për PZHL ia jep ato një ekipi studimi të përbërë nga 15-30 qytetarë të interesuar. Çdo ekip studimi bën analizën e vet mbi çështjen e caktuar dhe i raporton këtij grupi gjetjet bashkë me qëllimet dhe strategjitë e hartuara për arritjen e këtyre qëllimeve. Një qëllim është një rezultat që komuniteti kërkon të arrijë dhe që shpeshherë shfaqet si një sfidë. Për shembull, një qëllim i ekipit të studimit për edukimin mund të jetë ndërgjegjësimi, përfshirja dhe mbështetja më e madhe e komunitetit ndaj institucioneve arsimore. Në këtë rast, komuniteti rekomandon edhe strategjinë e duhur për të arritur këto qëllime.

3.8.5 Formulimi i planit të veprimit

Pas përcaktimit të qëllimeve dhe hartimit të strategjive, duhen përcaktuar zbatuesit kryesor dhe grupet mbështetëse për secilën strategji dhe si rrjedhojë lind nevoja për hartimin e një plani veprimesh i cili shërben për vënien në praktikë të strategjisë. Plani i veprimit duhet të listojë hapat konkretë që duhen ndjekur, të përcaktojë personat ose grupet që marrin përsipër këto hapa si dhe duhet të sigurojë që detyrat të përmbushen në bazë të një agjende e cila duhet vlerësuar përgjatë procesit. Zbatuesit kryesorë janë individë ose grupe të cilat marrin përsipër përgjegjësi strategjike ndërkohë që grupet mbështetëse i ndihmojnë të vazhdojnë veprimet.

Ndërkohë që plani i veprimit rekomandohet nga grupet e studimit, ato shpeshherë zhvillohen nga Grupi PZHL dhe legjitimohen nga donatorët pasi qëllimet dhe strategjitë t'i jenë raportuar Komitetit të Planifikimit.

3.8.6 Zbatimi i planit të veprimeve

Një plan veprimi i hartuar mirë ndihmon procesin e zbatimit duke ofruar një perceptim të plotë të detyrave dhe të kohës për realizimin e tyre. Për rrjedhojë, zbatimi duhet të ndjekë hap pas hapi planin e veprimeve. Padyshim që ngjarje të paparashikuara mund të shfaqin nevojën për ndryshime përgjatë procesit. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që të monitorohet hap pas hapi procesi i zbatimit.

3.8.7 Monitorimi i rezultateve

Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të planifikimit strategjik ju ofron donatorëve të qeverisjes lokale informacionin e nevojshëm për të vlerësuar progresin e arritjes së qëllimeve dhe strategjive të rekomanduara, të adaptuara nga komuniteti. Marrja e vazhdueshme dhe e programuar e vlerësimeve mundëson krijimin e një sistemi paralajmërues i cili njofton Grupin për PZHL në rast se aktivitetet nuk kryhen në përputhje me planin e veprimeve. Në vijim, Grupit PZHL mund t'i duhet të kryejë skanime periodike të mjedisit për t'u siguruar që mundësi të ndryshme nuk janë mënjanuar dhe zhvillime të paparashikuara jashtë komunitetit të mos pengojnë zbatimin e planit të veprimeve. Së fundi, monitorimi duhet gjithashtu të lokalizojë shpenzimet dhe shpërndarjen e burimeve.

3.8.8 Drejtoria e Shërbimit Këshillimor mund të ndihmojë

Planifikimi strategjik është një aktivitet mirëfilli komunitar. Gjithsesi, komunitetet e interesuara për

procesin e planifikimit lokal mund të bashkëpunojnë gjerësisht me zyrat dhe punonjësit e drejtorive rajonale të Shërbimit Këshillimor. Punonjësit rajonalë të këtij shërbimi mund të lehtësojnë procesin e planifikimit duke organizuar takime, duke siguruar mjedise të përshtatshme për këto takime, si dhe duke prezantuar ekspertë të fushës të cilët mund të ofrojnë këshillim sëbashku me ta. Në vijim, specialistët e Shërbimit Këshillimor mundësojnë informacionin e nevojshëm për analizën e mjedisit. Ata gjithashtu mund të asistojnë në trajnimin e grupeve të ndryshme të PZHL duke ndihmuar në hartimin e planeve të punës dhe agjendave të takimeve dhe sugjerimin e formateve për raporte të dobishëm. Së fundi, ata mund të japin perspektivën e tyre për komunitete të tjera rurale fqinje dhe çështjet, problemet që janë identifikuar ose janë në procesin e identifikimit atje.

3.9 Parimet kryesore të Planifikimit të Zhvillimit Ekonomik Lokal

3.9.1 Planifikimi duhet të jetë aktual dhe i rëndësishëm.

Më ndryshimin e tregjeve, teknologjisë dhe faktorëve të tjerë, planet ekonomike të disa viteve më parë mund të mos jenë të zbatueshme në mjedisin e sotëm ekonomik. Procesi i planifikimit duhet të jetë konsistent dhe të maksimizojë mundësitë që shfaqen dhe të adresojë sfidat konkurruese.

3.9.2 Planifikimi duhet të ketë qëllime të përcaktuara dhe ndara qartë

Sikurse në të gjitha veprimet me bazë të gjerë, një vizion i ndarë dhe qëllime të përcaktuara qartë jep mundësi të fuqizohen përpjekjet për zhvillim. Këto "Çështje dhe Mundësi" (elementët e kërkuar) sigurojnë bazën e duhur për renditjen e burimeve dhe përcaktimin e partnerëve potencialë. Qëllimet në fjalë nuk duhet të jenë deklarata përsosmërie të cilat premtojnë "vende të mira pune për të gjithë banorët", ashtu sikurse nuk duhet të jenë një listim i thjeshtë i projekteve më të mëdha të zhvillimit.

3.9.3 Koordinim me planet e tjera lokale

Planet efektive të zhvillimit lidhin strategjitë e zhvillimit ekonomik me planet për përdorimin e tokës bujqësore dhe urbane, transportin, infrastrukturën dhe fuqinë punëtore në nivel komune, qarku dhe më gjerë. Komunitetet duhet të kërkojnë të rendisin veten e tyre me partnerët strategjikë të cilët mund të sigurojnë informacion të vlefshëm, shërbime dhe produkte për këtë sipërmarrje kolektive.

Bashkëpunimi ndër-komunal dhe në nivel qarku është një element i domosdoshëm për të bërë të mundur që komunitetet të maksimizojnë efektivitetin e burimeve të kufizuara, të gjenerojnë ide të reja, të ndajnë punën për të kursyer kohë, t'i japin rëndësi talentit të partnerëve të ndryshëm, të projektojnë një imazh më të fortë dhe të bazuar në vlera për bizneset dhe njerëzit jashtë rajonit të caktuar. Veprimet e komuniteteve mund të kenë efekt të konsiderueshëm në rritjen e fqinjëve të tyre. Duke koordinuar përpjekjet e tyre, komunitetet fqinjë mund të:

- P arashikojnë dhe planifikojnë mundësitë dhe rreziqet në nivel rajonal
- P lanifikojnë përdorimin efektiv të burimeve të kufizuara dhe/ose të përbashkëta
- R eduktojnë prurjet negative të zhvillimit të ri të paparashikuar

3.9.4 Njihni tregun tuaj

Analiza ekonomike mund të zbulojë mundësitë, të ekspozojë rreziqet dhe mund të shërbejë si bazë për një planifikim të fortë. Planifikimet më të mira përfshijnë informacion cilësor dhe sasior mbi prirjet dhe zhvillimet ekonomike.

PZHL-ja jonë ka të bëjë me të menduarin në terma afatgjatë në lidhje me nevojat e zhvillimit të komunës. Sidoqoftë, hartuesit e PZHL duhet të mbajnë parasysh edhe Strategjinë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun përkatës, si dhe të sigurohen që ky plan hartohet në një linjë me Objektivat Rajonale dhe Kombëtarë të Zhvillimit për Mijëvjeçarin. Në këtë mënyrë zhvillimi ekonomik lokal është i influencuar në mënyrë të argumentuar nga të gjitha aktivitetet e qeverisjes lokale. Gjithsesi, politikat e zhvillimit ekonomik lokal janë përgjithësisht të përcaktuara në mënyrë të kufizuara si aktivitete speciale të ndërmarra nga grupe publike ose private për të promovuar zhvillimin lokal.

Aktivitete të quajtura "programe të zhvillimit ekonomik" përgjithësisht ndahen në dy kategori:

- a) Sigurimi i asistencës specifike për biznese individuale të cilat mendohen të sjellin përfitime më të mëdha të zhvillimit ekonomik, dhe
- b) Iniciativa strategjike në të cilat taksat, shpenzimet dhe politikat rregulluese ndryshojnë për të promovuar zhvillimin ekonomik lokal.

Edhe pa këto përpjekje qeveritare, zhvillimi ekonomik lokal do të ndodhë. Gjithsesi, programet lokale të zhvillimit ekonomik mendohen se rrisin cilësinë dhe sasinë e zhvillimit ekonomik lokal.

- **Të takosh njerëz duke ecur**

Përzgjedhja e palëve të nevojshme është një proces që kërkon kohë. Duhet të përpiqeni të takoni sa më shumë njerëz të jetë e mundur. Shpeshherë, si rezultat i këtij procesi, njerëzit e identifikojnë veten si kritikë ndaj grupeve të interesit për shkak të dijeve, influencës, entuziazmit ose përkushtimit specifik të rajonit.

- **Krijoni një bazë të dhënash**

Ndërkohë që takoni njerëz, mblidhni kontaktet e tyre në mënyrë që të ndërtoni një bazë të dhënash. Kjo do të rezultojë e dobishme më vonë kur të përpiqeni të gjeni njerëz me aftësi, dije dhe interesa specifike apo kur do të doni t'i thërrisni në një mbledhje apo grup të fokusuar. Të gjithë këta njerëz nuk mund të jenë në grupin tuaj të referencës, por janë palët tuaja.

- **Zgjidhni palët për një grup reference**

Grupi i referencës është i rëndësishëm, pasi ai do të punojë me ju për të vënë në praktikë ide që do të përmirësojnë ekonominë lokale kohë pas kohe. Ju po kërkonit njerëz që e njohin komunitetin, pikat e forta dhe të dobëta të tij dhe janë të përkushtuar të punojnë me ju gjatë të gjithë procesit të zhvillimit ekonomik lokal duke ju ndihmuar të zbatoni strategjitë dhe iniciativat me kalimin e kohës. Gjithashtu,

do t'ju nevojiten njerëz nga zona të ndryshme gjeografike dhe interesi si dhe të balancuara përsa i përket moshës dhe gjinisë.

Shembull

- Çfarë departamentesh dhe zyrtarë të qeverisë duhen përfshirë?

Komuniteti	Përfaqësues të organizatave kryesore të komunitetit Individë të njohur e të respektuar në komunitet Përfaqësues të grave, rinisë dhe papunëve
Agro-industria dhe biznesi	Drejtimesit e punëdhënësve kryesorë të zonës Përfaqësues të shoqatave të fermerëve Përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Bizneset lokale dhe shoqatat e tyre
Qeveria	Zyrtarë të qarkut Zyrtarë të komunave përreth Zyrtarë të zhvillimit të aftësive rajonale si p.sh. nga Drejtoria Arsimore, Drejtoria Shëndetësore dhe Drejtoria e Shërbimit Këshillimor të qarkut

departamente të qarkut duhen përfshirë si dhe kush njerëz duhet të punojnë bashkë për arritjen e zhvillimit ekonomik lokal. Politika dhe ndërhyrje të tjera të qeverisë qendrore prekin zhvillimin ekonomik lokal përmes politikave dhe veprimeve të veta duke prekur në këtë mënyrë rajonin tuaj; për këtë arsye, të tilla marrëdhënie nuk duhen neglizhuar.

- Takimi juaj i parë më palët e grupit të referencës.

Në takimin tuaj të parë më grupin e referencës, do të ishte mirë të hartoni pikat e referencës: për çfarë është përgjegjës grupi? Si do të bashkëpunojnë ata? Kujt duhet t'i raportojnë? Si do të mbliohen?

- Vendosni se në ç'mënyrë njerëzit kontribuojnë më shumë.

Për disa mund të mos jetë e nevojshme të jenë gjithmonë të pranishëm në mbledhje. Ndërkohë që për disa të tjerë është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e rregullt si p.sh. për punonjësit lokalë, Drejtoria Arsimore e Qarkut, etj. Por ju mund të zgjidhni gjithashtu që grupe të vogla pune që takohen në periudha të shkurtra kohore të fokusohen në një çështje të caktuar.

- Ofroni një vizion

Ju do të doni që takimi juaj i parë të përcaktojë objektiva të gjera për grupin e referencës. Ftoni kryetarin e komunës ose liderë të tjerë të paraqesin vizionin e tyre mbi strategjinë ekonomike që ju po synoni të arrini.

4. Kuadri Kohor

Për planifikimin e zhvillimit lokal hartohet paraprakisht një plan-veprimi afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Ky vizion hedh vështrimin drejt 10-15 viteve të ardhshme dhe përcakton objektiva strategjike për afatin pesëvjeçar. Megjithatë, për të qenë realist dhe për të qenë të sigurt që komuniteti është i aftë të përqendrohet në projekte dhe në veprime konkrete, qëllimi i veprimit është të ngushtohet në afatin trevjeçar dhe veçanërisht i adresuar gjatë përgatitjes së buxhetit. Çdo hap veprimi përmban një afat kohor për zbatimin e tij. Përputhshmëria me këto afate është të monitorohet nga Nëngrupi MPV në proces.

5. Masat për fillimin e procesit

Dokumenti “Udhëzues Praktik i Planifikimit të Zhvillimit Lokal me Pjesëmarrje” është hartuar për të orientuar lexuesin metodologjikisht në çdo hap të procesit. Në përputhje me përvojat më të mira të planifikimit të zhvillimit lokal brenda dhe jashtë vendit, ky dokument trajton në pjesë të ndryshme të tij aspekte të ndryshme të procesit të planifikimit që lidhen kryesisht me: drejtimin e planifikimit, Planet e Punës të Zbatimit, Rishikim Parapërgatitor dhe aspekte të tjera specifike. Në këtë mënyrë “Udhëzuesi Metodik” ofron një doracak të detajuar në hapa për të hartuar një Plan të Zhvillimit Lokal. Çdo hap përmban informacion mbi rezultatet e pritshme, veprimtaritë dhe detyrat përkatëse; pse është hap i rëndësishëm, si të organizohet çdo veprimtari dhe çfarë mjetesh dhe përgatitje është e nevojshme për përmbushjen e secilës prej tyre (veprimtarive).

Planet e punës të zbatimit ofrohen për koordinatorin e terrenit⁴ dhe Kryetarin e grupit të planifikimit të zhvillimit lokal. Këto janë plane tejet të detajuara veprimi për zbatuesit dhe japin një shpjegim të mirë për të gjithë përfaqësuesit mbi sa detaje duhet për të planifikuar çdo hap, e për t'i përmbushur vetë ato.

Infrastruktura e trajnimit përbehet nga tërësia e materialeve trajnuese të parapërgatitura, modele të ndërgjegjësimit publik dhe nxitjes së pjesëmarrjes së komunitetit, si dhe nga mjete të tjera që janë të lidhura me çdo hap të procesit. Këto gjithashtu mund të ofrohen edhe në një CD në mënyrë që përdoruesit lokal të mund t'i modifikojnë dhe t'i përshtatin ato sipas kushteve të tyre specifike të komunës.

Në përfundim, seksioni i punës përgatitore ofron mundësinë për krijimin dhe mbajtjen e një dosjeje të plotë të artikujve, botimeve mbi përvojat e mëparshme, etj., në dobi të planifikimit të zhvillimit lokal, dokumente të cilat ju mundësojnë pjesëmarrësve përmirësimin hap pas hapi të aftësive të tyre, përfitimin e njohurive plotësuese, etj. Në këtë dosje mund të vendosen edhe modele materiale studimore që janë të nevojshme për fushën, plane të zhvillimit lokal të përgatitura në komuna me kushte ekonomiko-shoqërore të ngjashme, etj.

4) Në kuptimin e këtij Udhëzuesi, me “koordinatorë të terrenit” do të kuptojmë punonjësin e MADA-s ose/edhe specialistë të tjerë të kontraktuar prej saj që mbulojnë një territor të caktuar, veprimtaria kryesore e të cilëve është siguri i asistencës teknike dhe bashkërendimi i procesit të hartimit të planeve të zhvillimit lokal me titullarët dhe stafet drejtuese të komunave në zonën malore përkatëse.

KAPITULLI II

Hartimi i planit të zhvillimit lokal

Realizimi i procesit të vlerësimit lokal dhe përgatitja e planit strategjik për zhvillimin ekonomik është i përbërë nga disa faza, të cilat jepen në vijim. Organizimi për fillimin e procesit të zhvillimit ekonomik, mbledhja e informacioneve dhe të dhënave, analiza dhe interpretimi i të dhënave dhe informacioneve të grumbulluara, përcaktimi i strategjive alternative të zhvillimit ekonomik, zgjedhja e strategjive përkatëse dhe projekteve dhe aktiviteti i fundit është vënia në jetë e strategjive dhe projekteve të përzgjedhura.

1. Organizimi për fillimin e procesit të zhvillimit ekonomik, përpjekjet për iniciimin e zhvillimit ekonomik duhet të fillojnë nga liderët lokalë apo komisioni për zhvillimin ekonomik të cilët duke i nxitur të gjithë ata që janë të gatshëm të angazhohen në procesin e zhvillimit lokal. Ndërkaq, në nivel komune, komisioni për zhvillimin ekonomik duhet të angazhohet drejtpërdrejtë në vlerësimin lokal dhe në përgatitjen e planeve përkatëse.
2. Mbledhja e informacioneve dhe të dhënave, para se të formulohet vendimi për strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal është e domosdoshme që të mundësohet një pasqyrë për gjendjen momentale dhe prirjet kryesore të zhvillimit të komunës në momentin e hartimit të PZHL. Informacioni për gjendjen ekonomike të komunës mund të sigurohet në bazë të dhënave statistikore të ekonomisë nga burimet zyrtare dhe jo-zyrtare, si dhe informacionet e ndryshme të siguruar nga studimet, vëzhgimet, analizat e aktorëve të ndryshëm që kanë vepruar ose veprojnë aktualisht në territorin e komunës, por edhe nga takimet me njerëzit që jetojnë në atë territor. Në rastin e fundit mund të përdoren edhe pyetësorë të ndryshëm, rezultatet e përpunimit të të cilëve do të ndihmojnë shumë në procesin e vlerësimit.
3. Analiza dhe interpretimi i të dhënave dhe informacioneve të grumbulluara, të dhënat dhe informacionet sasiore dhe cilësore duhet të analizohen dhe të interpretohen me qëllim që të jepet një pasqyrë e hollësishme, e cila do të jetë një bazë e fortë për projeksionet

e ardhshme të komunës dhe mbi të cilën mund të gjenerohen nisma të ndryshme apo projekte zhvillimore. Në këtë fazë fitohen njohuri për llojet e agro-industrisë, pozitën, gjeografike, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sipërmarrësin, pasuritë natyrore, të punësuarit, infrastrukturën publike, etj. me qëllim që të identifikohen avantazhet krahasuese. Në këtë fazë do të identifikohen anët e forta, anët e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet apo pengesat ndaj zhvillimit ekonomik lokal. Gjithashtu në këtë fazë do të identifikohen edhe nevojat e komunitetit. Këtu duhet të identifikohen më shumë nevoja që mund të realizojë qeverisja lokale, të vendoset se cilat nevoja janë më të rëndësishme apo prioritare në funksion të zhvillimit ekonomik lokal. Një nga mënyrat për realizimin këtij hapi është analiza e mundësive të qeverisjes lokale për të mbështetur zhvillimin e sipërmarrjeve private mbi bazën e mundësive ekonomike që mund të ofrojë komuna për këtë qëllim.

Formulimi i alternativave strategjike për zhvillim lokal, nga identifikimi i problemeve dhe nevojave në këtë fazë duhet të analizohen strategjitë e ndërhyrjes. Si strategji të përcjellura me masa mund të përmendim:

- Ndhmë ndaj bizneseve ekzistuese lokale që të përmirësohen dhe të zgjerohen. Disa teknika të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të bizneseve ekzistuese janë: sponsorizimi i programeve për trajnime të drejtuesve të biznesit; nxitja e kryetarëve të komunave që të vizitojnë rregullisht firmat private në territorin e tyre me qëllim që të kuptohen, përpjekjet e komunës dhe vullneti për të mbështetur zgjerimin dhe fuqizimin e tyre; identifikimin e burimeve të kapitalit të cilat i plotësojnë nevojat e bizneseve lokale; informimi i vazhdueshëm i tyre mbi zhvillimet e reja teknologjike që mund të përmirësojnë efikasitetin; sigurimi i shërbimeve lokale dhe në nivel qarku, me qëllim që t'u plotësohen nevojat sipërmarrjeve lokale; sponsorizim i aktiviteteve të cilat paraqesin dëshirën e shoqërisë për të kontribuar në zhvillimin e firmave lokale etj.
- Nxitja e formimit të firmave të reja në territorin e komunës. Kryetarët e komunave duhet të mendojnë se cilat hapa duhen ndërmarrë prej tyre për përmirësimin e klimës së bizneseve të reja. Në këtë drejtim duhen shfrytëzuar mundësi të ndryshme si: ofrimi i trajnimeve të nevojshme për fillimin e biznesit për sipërmarrësit fillestar, trajnime në fushën e marketingut të produkteve bujqësore e blegtorale, rritjen e aftësive për planifikimin e zhvillimit të biznesit, mbështetje e nismave për kryerjen e investimeve të diasporës shqiptare në vendlindje (territorin e komunës), etj.
- Përmirësimi i aftësive të stafit të komunës në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve komunale, rritje e kapaciteteve profesionale të tyre në marrëdhëniet me prodhuesit dhe shitësit lokal; mbështetje bizneseve për të identifikuar potencialin e tregut lokal përmes sigurimit të informacionit bazë social-ekonomik edhe/ose kryerjes së studimeve dhe analizave të përbashkëta; koordinim i veprimtarive sipërmarrëse në komune, etj.

- Tërheqja e punëdhënësve të rëndësishëm nga komuna/qarqe tjera, nëse qarku dhe komuna duan të tërheqin firma nga rajone te tjera atëherë mund të ndjekin disa strategji: identifikim i zonave përkatëse për zhvillimin e agro-industrisë dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të nevojshme; promovimi i dobisë së investimeve në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të komunës; studimi i përfitimeve nga ndonjë sipërmarrje e re ose nga kapacitetet prodhuese e përpunuese të prodhimeve bujqësore e blegtorale të vendosura në komunat e afërta, etj.
 - Shtimi i investimeve të përfituara nga komuna nëpërmjet investimeve në projekte kombëtare, projekteve të OJF-ve dhe donatorëve ndërkombëtarë, përpjekja që të rritet ndikimi pozitiv i programeve për investime me interes kombëtar, projekteve nga OJF dhe fondeve të donatorëve të ndryshëm në zhvillimin lokal ka një rëndësi të madhe. Në këtë drejtim duhet t'i përdorim disa apo të gjitha veprimtaritë vijuese: informimi i banorëve të komunës për të drejtat e tyre për përdorim të formave të ndryshme të programeve mbështetëse të zhvillimit ekonomik, shtimi i përpjekjeve për tërheqjen e investitorëve vendas dhe të huaj për përmirësimin e infrastrukturës publike komunale si rrugët, kanalizimin, ujësjellës, shkolla, ambulance, etj.
5. Përzgjedhja e strategjisë dhe projekteve adekuate, qeverisja lokale mund ta realizojë këtë përzgjedhje duke analizuar përfitimet dhe risqet e çdo projekti të veçantë duke përzgjedhur ato strategji dhe projekte që kanë më pak shpenzime dhe që sjellin përfitime më të mëdha, kuptohet duke respektuar rigorozisht teknikat përkatëse të vlerësimit sidomos në aspektet mjedisore dhe afat-gjatë.
 6. Vënia në jetë e strategjive të përzgjedhura dhe projekteve, mbas arritjes së një konsensusi të gjere në komisionin komunal të zhvillimit ekonomik për strategjitë dhe projektet që do të realizohen, vjen faza e mbështetjes së zbatimit të tyre. Vënia në jetë e projekteve të përzgjedhura bën të nevojshme që të formohet grup pune i posaçëm për secilin projekt, ndërsa hartohet një plan pune i hollësishëm në të cilin përcaktohen veprimet, sigurimi i një mbështetjeje sa më të gjerë publike, etj.

Procesi i menaxhimit të planit të zhvillimit strategjik është një nga proceset më të rëndësishëm të planifikimit të zhvillimit ekonomik. Menaxhimi strategjik paraqet konceptin se si mund të shfrytëzohen në mënyrë efikase burimet në dispozicion, ndërsa si pikë referimi është përmirësimi i kushteve dhe i cilësisë së jetesës së banorëve të komunës. Ato janë:

1. 5 Fazat dhe 10 Hapat që duhen Ndërmarrë

Një proces planifikimi strategjik i zhvillimit ekonomik lokal kalon nëpërmjet pesë stadeve kryesore.

Stadi

Organizimi i Përpjekjes

Stadi

Drejtimi i një Vlerësimi Ekonomik Lokal

Zhvillim të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal (përfshirë vizionin, qëllimet, objektivat e programet si dhe planet e veprimit)

Vënia në jetë e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal

Rishikim i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal

Strategjia do të identifikojë fushat me mundësi ekonomike dhe vështirësi për t'u kapërcyer, një informacion kyqë do të drejtojë iniciativën e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe ndërhyrjet potenciale.

Faza 1:

Mbështetje Ndërtuese

HAPI 1: SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË LOKALE

Ky hap siguron që zyrtarët e qeverisjes vendore dhe personeli të njihen me qëllimet e projektit dhe në të njëjtën kohë të angazhohen në hartimin e planit të zhvillimit lokal.

Veprimtaritë kryesore të këtij hapi kanë të bëjnë me sa vijon:

- Përgatitja e prezantimit përmbledhës
- Paraqitja e një prezantimi tek Kryetari i komunës dhe të ftuarit e tjerë
- Përgatitja e Kryetarit të Komunës për të prezantuar konceptin e PZhL
- Prezantim në Këshillin e Komunës për miratim konceptual (në parim)
- Mbikëqyrje e caktimit të Grupit të PZhL, Grupi Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje (MVP)

Këto janë hapat e parë në krijimin e Planit të Zhvillimit Lokal. Një proces i suksesshëm nuk mund të fillojë pa patur mbështetjen e plotë nga zyrtarët e zgjedhur lokal, administratës lokale dhe liderët e komunitetit. Është po ashtu e rëndësishme të kesh një nivel të lartë pjesëmarrjeje të komunitetit lokal dhe një gamë të gjerë aktorësh, përfaqësues të grupeve të interesit. Të gjitha këto mund të arrihen në sajë të një kuptimi të mirë të parimeve të projektit dhe aftësisë për t'ia transmetuar këto grupit të punës dhe zyrtarëve lokalë.

Në fund të kësaj faze zyrtarët lokalë do të kenë një njohje dhe perceptim të mirë mbi procesin e planifikimit të zhvillimit ekonomik lokal dhe do të japin konsensusin e tyre si dhe angazhimin për procesin dhe veprimtaritë që duhen kryer, pjesëmarrja do të mund të arrihet ndërmjet një game

të gjerë aktorësh, përfaqësues të grupeve të interesit dhe grupi i punës do të ketë një agjendë të gatshme për veprimet e ardhshme.

Për të pasur një PZhL, zyrtarët e zgjedhur, administrata lokale dhe anëtarët e komunitetit duhet të deklarojnë mbështetjen e tyre për përpjekjen. Një angazhim formal nënvizon rëndësinë e iniciativës, autorizon stafin për të punuar mbi to, dhe ndihmon në përsheptimin e veprimit brendapërbrenda qeverisjes lokale dhe komunitetit. Angazhimi fillestar shprehet nëpërmjet një Memorandumi të Mirëkuptimit që përcakton pritshmërinë e procesit, veprimtaritë kryesore dhe angazhimin kohor të përfshirë në një plan zhvillimi dhe rolet e përgjegjësitë e pjesëmarrësve. Në këtë fazë fillestare, një përpjekje e vlefshme do të bëhet për të transmetuar qëllimin dhe procesin për planifikimin e zhvillimit lokal tek të gjithë pjesëmarrësit e projektit, pasi ata do të përfitojnë nga projekti, nga zhvillimi i planit nëpërmjet zbatimit dhe monitorimit të rezultateve.

Gjatë kësaj faze ngrihet Grupi i PZhL. Është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët e interesuar në komunë dhe përfaqësues të komunitetit të gjerë të marrin pjesë dhe të kenë zërin e tyre në këtë grup duke u ndjere anëtarë të tij. Kjo është arsyeja pse përbërja e sugjeruar e grupit të PZhL është me bazë të gjerë dhe me diversitet brenda tij duke përfshirë zyrtarë të zgjedhur, përfaqësues të administratës lokale, shoqatave të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile e banorëve të thjeshtë.

Si shenjë të demonstrimit të mbështetjes, Këshilli komunal emëron 2-3 anëtarë të tij, duke preferuar ata që përfaqësojnë spektrin politik, për të shërbyer në grupin e PZhL dhe Kryetari i Komunës cakton stafin kryesor të angazhohen në përbërje të grupit. Përzgjedhja e anëtareve të komunitetit dhe përbërja e tyre është themelore për zbatimin me sukses të parimit të gjithëpërfshirës. Është po kaq e rëndësishme që i gjithë procesi të shihet si një sipërmarrje e qeverisjes vendore, ndaj dhe stafi i emëruar dhe zyrtarët e komunës duhet të përfshihen në grupin këshillimor.

a) Pse ndërtimi i Partneritetit Lokal është i rëndësishëm për Suksesin?

Veprimtaria kryesore e këtij hapi ka të bëjë me sa vijon:

- Ndërtimi i Grupit i Planit të Zhvillimit Lokal

Partneritetet janë thelbësore për një Plan efektiv të Zhvillimit Lokal. Nëpërmjet një partneriteti njerëz dhe organizata të ndryshme punojnë sëbashku për të adresuar interesa dhe shqetësime të përbashkëta. Një partneritet i hapur është ruga më e lehtë dhe më efiçente për të krijuar një PZhL, sepse çdo njeri është i përfshirë që në fillim. Kjo do të thotë që plani në formën përfundimtare të tij do të ketë konsensusin nga të gjitha palët që kanë një angazhim në zhvillimin lokal.

b) Cili është roli i grupit të PZHL-së?

Grupi i PZhL është përgjegjës për udhëheqjen, për sigurimin e drejtimit dhe të këshillave, si dhe për mbikëqyrjen e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal. Grupi i PZhL është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e planit përfundimtar të propozuar të Zhvillimit Lokal për ta paraqitur atë në Këshillin e Komunës për aprovim, si dhe lançimin dhe monitorimin e zbatimit të tij.

c) Kush duhet të përfshihet në Grupin e Planit të Zhvillimit Lokal?

Përbërja e Grupit të Planifikimit të Zhvillimit Lokal:

- ✓ Zyrtarë Lokalë të Zgjedhur
- ✓ Organizata të shoqërisë civile
- ✓ Organizata të grupeve sociale me aftësi të kufizuara
- ✓ Grupe ambientaliste
- ✓ Administrata Komunës
- ✓ Organizata profesionale (p.sh shoqata të biznesit/Fermerë/Mësues/
- ✓ Punonjës të Shëndetësisë/ Shoqata Profesionale)
- ✓ Njerëz përfitues të ndihmës ekonomike
- ✓ Gratë
- ✓ Të Rinjtë
- ✓ Pensionistët
- ✓ Banorët

NËNGRUPI I MOBILIZIMIT TË KOMUNITETIT (NMK)

Përbërja: Anëtarët e Grupit Planit të Zhvillimit Lokal

Roli: Të ndërgjegjësoje publikun për pjesëmarrje në procesin e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal dhe zbatimin e tij.

Përgjegjësitë:

- a) Fushatë ndërgjegjësimi të publikut (Të organizojë dhe të sigurojë suksesin e të gjitha veprimtarive)
- b) Panairët e Ideve për Vizionin Komunitar – PIVK (Të identifikojë dhe trajnojnë vullnetarë për të mirëpritur panairët/ Të ndihmojnë në lehtësimin e panairëve/ Të grumbullojnë dhe të përpunojnë informacionin nga panairët tek sekretariati)
- c) Grupet e Fokusuara - FG (Të organizojë grupet e fokusuara sipas nevojave)
- d) Seancat e Këshillit për Hartimin e Strategjisë (Të asistojë koordinatorin lokal të MADA-s kur të jetë e nevojshme, të lehtësojnë takimet/ Të mbledhë dhe të përpunojnë informacionin

nga FFV-të tek Sekretariati)

- e) Përgatitja e Raportimit për çdo veprimtari për koordinatorin lokal të MADA-s.

SEKRETARIATI

Përbërja: 2 anëtare të Grupit të PZhL

Roli: Të sigurojë dhe dokumentojë informacionin e mbledhur nga përpunimi i të dhënave dhe Pjesëmarrja e Nëngrupeve

Përgjegjësitë:

- Të sigurojë mbledhjen e të dhënave në kohën e duhur
- Të mirëmbajë informacionin në vendin e përshtatshëm dhe të sigurt
- T'i përcjellë informacionin koordinatorit lokal dhe të tjerëve, sipas kërkesës dhe në kohën e duhur

NËNGRUPET E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE (NMDH)

Përbërja: Anëtarët e Grupit të PZhL

Roli: Të sigurojë mbledhjen e të dhënave të përshtatshme për analizën e gjendjes

Përgjegjësitë:

- Anketimi i Banorëve** (Hartimi i shembullit rastësor për banorë/ Identifikim/ trajnim të vullnetarëve për të drejtuar Anketimi i banorëve/ Sigurimi i kryerjes së suksesshme të Anketimit të banorëve)
- Profili i Komunës** (Të dërgojë pyetësorin dhe metodikën e mbledhjes së të dhënave personave/zyrave përkatëse dhe të mbledhë të dhëna kur të jenë të gatshme / Kontrolli i të dhënave për saktësinë)
- Mbledhje dhe dorëzim të rezultateve** të Anketimit të banorëve dhe Profilin të Komunës pranë Sekretariatit

Roli dhe Përbërja e nëngrupit të Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje

a) Pse procesi i monitorimit dhe rezultatet janë të rëndësishme për suksesin?

Monitorimi i efektivitetit të punë së qeverisjes vendore është i rëndësishëm për një numër arsyesh. Për dikë, bën të mundur që institucioni të japë llogari ndaj aktorëve të grupeve të interesit, me të cilët është duke bashkëpunuar ose synon të bashkëpunojë, çfarë ka premtuar për të bërë dhe çfarë po bën. Monitorimi i rregullt dhe i vazhdueshëm i rezultateve ose plani strategjik i lejon

organizatës të identifikojë që herët problemet e hasura në arritjen e objektivave, duke i dhënë mundësi në këtë mënyrë të ndërhyjë në kohë për rregullimin përkatës në shërbimin në fjalë.

b) Cili është roli i nëngrupit të Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje (MVP)?


Nëngrupi i MVP përdor teknikat e matjes së performances përgjatë zhvillimit të planit në mënyrë që të vendosë kritere për vlerësimin e procesit të PZHL dhe për të asistuar nën-grupet në fushat prioritare në përcaktimin e treguesve të performancës për objektiva strategjik dhe hapat e veprimit. Mbas plotësimit dhe adaptimit të planit, anëtarësimi në nëngrupin e PME-së do të zgjerohet; grupi do të ngarkohet me përgjegjësi për monitorimin dhe vlerësimin periodik të arritjes së objektivave të planit, si dhe të komunikojë arritjet dhe sfidat e hasura të Këshillit komunal dhe banorët.

c) Kush është i përfshirë në Nëngrupin e MVP-së?

Nën-Grupi i Monitorimit dhe Vlerësimi me Pjesëmarrje

(I zgjeruar, Viti i II-të)

Figura: Skema e Përbërjes së Nën-Grupi i Monitorimit dhe Vlerësimi me Pjesëmarrje



Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

MADA prezanton konceptin dhe procesin tek Kryetari i Komunës. Gjithashtu, koordinatori lokal ndjek mbledhjen e Këshillit të komunës duke asistuar për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje dhe duke ofruar sqarime të mëtejshme. Në këtë stad zhvillimi, është e rëndësishme të ofrohet një vështrim i përgjithshëm i roleve specifike të grupeve këshilluese në procesin e PZHL dhe parimet/praktikat e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse. Ky prezantim mund të organizohet në seancën e parë të Këshillit komunal.

HAPI 2.

PËRCAKTIMI I DREJTIMIT

Gjate këtij hapi, pritet të arrihen këto rezultate kryesore:

- Anëtarët e grupit të PZHL-së të kenë një ide të qartë rreth objektivave të projektit, rezultateve dhe rolit të tyre në këtë proces.

- **MADA** të ketë një ide të qartë të nevojave për trajnim të pjesëmarrësve të komunës
- **H** artimi i një plani pune dhe një kalendar zbatimi nga grupi i PZHL-së

Kryetari i Komunës mbledh sëbashku të gjithë anëtarët e grupit të PZHL, Grupit të Monitorimit dhe të Vlerësimit me Pjesëmarrje dhe Grupit të Mobilizimit të Komunitetit për një workshop trajnimi dy-ditor rreth PZHL/PME dhe strukturës e metodologjisë së propozuar. MADA do të ofrojë këtë trajnim duke përcaktuar edhe një kalendar për zbatim. Qëllimi i workshopit është të orientojë më mirë stafin e komunës dhe pjesëmarrësit kryesorë në këtë proces, të marrë inputet, të identifikojë parametrat e analizës së gjendjes, të diskutojë komponentët e përfshirjes, etj. Ky workshop është edhe një mundësi e mirë për të kryer një "vlerësim të nevojave për trajnim". Pjesëmarrësit e komunës mund të ofrojnë një vlerësim të rezultateve të arritura në aftësimin dhe njohuritë e tyre në mënyrë që të identifikohen nevojat e ardhshme apo aktuale për trajnim.

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

Organizim, koordinim, lehtësim dhe përgatitjen e materialeve për trajnimin gjatë workshopit. Gjithashtu, kërkohet të lehtësojë nevojat gjatë trajnimit/të vlerësojë burimet njerëzore dhe përgatisë rekomandime për trajnime të tjera, (nëse duhet).

HAPI 3.

TË FILLOSH

Gjatë këtij hapi, pritet të arrihen këto rezultate kryesore:

- **O** rganizimi i Mbledhjeve të para të planifikimit të Grupit të PZHL-së, për të hartuar planet përkatëse të veprimit, kalendarin kohor, rolin dhe përgjegjësitë.
- **p** rezantimi i Fushatës së Ndërgjegjësimit Publik
- **p** ër anëtarët e PZHL-së është shumë e rëndësishme ta njohin veten si një grup pune me eksperiencë dhe rol të rëndësishëm në këtë proces, me përgjegjësi të përcaktuara. Anëtarët duhet të pajisen me aftësitë bazë në përgatitjen e planeve të punës që duhet të përmbajnë detyra dhe afate kohore për përmbushjen e tyre.

Në këtë takim, Grupi i PZHL-së zgjedh një kryetar, secili nëngrup gjithashtu zgjedh një kryetar i cili do të veprojë si person ndërlidhës ndërmjet nëngrupit dhe sekretariatit të grupit të PZHL-së. Nëngrupet janë:

- **N** ëngrupi i Mbledhjes së të Dhënave
- **N** ëngrupi i Mobilizimit të Komunitetit
- **N** ëngrupi Pjesëmarrës në Monitorim
- **S** ecretariati

e mbledhjes së të dhënave, do të përgatisë planin e punës dhe identifikojë vullnetarët që do të punë dhe do të fillojë të përgatisë logjistikën për Panairin e Ideve në Komunitet, si dhe do të fillojë të planifikojë fushatën për ndërgjegjësimin publik. Nëngrupi i PME do të bjerë dakord mbi kriterin e vlerësimit dhe indikatorët për monitorimin e suksesit kundrejt arritjes së rezultateve të PZhL-së dhe matësve të tjerë të performancës.

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

Parashikimi i takimeve të para dhe ofrimi i asistencës teknike, sipas nevojës për të finalizuar Planin e Punës dhe Fushatën e Ndërgjegjësimit Publik

Udhëzime

Shembull për Çështje Diskutimi në Mbledhje dhe Pikat e Vendimit për Takimet Fillestare të PZhL-së

- **A** nëtarësia e Grupit të PZhL zgjedh një kryetar (sugjerohet të jetë një person i ndryshëm nga Kryetari i Komunës)
 - **F**inalizimi i Planeve të Punës. Planet e Punës të iniciuara gjatë Ditës së Dytë të trajnimit (Hapi 2) janë të finalizuara, duke marrë në konsideratë rolin dhe përgjegjësitë të secilit anëtar të grupit të PZhL-së. Koordinatorët Lokalë të MADA-s sigurojnë se planet e punës së Grupit të PZhL-së duhet të koordinojnë me planet e punës së saj.
 - **A** nëtarët e Grupit të PZhL marrin dhe diskutojnë mbi informacionin dhe materialet që përmbajnë çështje dhe detyra të ndryshme, siç janë raportimi efektiv dhe se si modërohet një mbledhje.
 - **D**iskutimi i nevojave të tjera për trajnim
- Grupi i PZhL-së organizon nëngrupe të tjera për të shkuar më në detaje rreth aktiviteteve të ardhshme

Shembull për Çështje Diskutimi në Mbledhje dhe Pikat e Vendimit për Takimet Fillestare të Nëngrupit të Monitorimit dhe Vlerësimit me Pjesëmarrje (MVP)

- **A** nëtarësia zgjedh kryetarin
- **F**inalizimi i Planeve të Punës. Planet e Punës të iniciuara gjatë Ditës së Dytë të trajnimit (Hapi 2) janë të finalizuara, duke marrë në konsideratë rolin dhe përgjegjësitë të secilit anëtar të grupit të MVP-së.
- **N**ëngrupi MVP përcakton kriteret për matjet e suksesit të zhvillimit të planit dhe finalizon një model për raportimin e progresit

Shembull për Çështje Diskutimi në Mbledhje dhe Pikat e Vendimit për Takimet Fillestare të Nëngrupit të Mbledhjes së të Dhënave (NMDh)

- **N**MDh zgjedh një kryetar (sugjerohet të jetë një person i ndryshëm nga Kryetari i Komunës)
- **R**ishikon detyrat e secilit dhe përcakton çfarë trajnimi tjetër është i nevojshëm
- **R**ishikon instrumentet e Profilit të Komunës dhe vendos detyra për mbledhjen e të dhënave
- **R**ishikon instrumentin e vrojtimit qytetar dhe modifikon atë nëse është e nevojshme
- **D**iskuton dhe jep shembuj të mundshëm
- **D**iskuton nëse është e nevojshme të marrin vullnetarë për zbatimin e punës në terren apo anëtare të grupit të PZhL; nëse vendoset për vullnetarët diskutohet trajnimi për ta.

Shembull për Çështje Diskutimi në Mbledhje dhe Pikat e Vendimit për Takimet Fillestare të nëngrupit të Mobilizimit të Komunitetit

- *Plani i Fushatës për Ndërgjegjësimin Publik: Komunikimi është një aspekt kritik i procesit të PZHL-së. Publiku duhet të dijë çfarë aktiviteteve janë duke ndodhur dhe se si mund të përfshihen në to. Për më tepër, grupi i PZHL-së duhet të komunikojë ndërmjet anëtarëve të vet në mënyrë që të gjithë të kuptojnë çfarë veprimesh do të ndërmerren gjatë gjithë procesit. Në çdo hap të procesit, planet e punës duhet të përfshijnë komunikimin dhe aktivitetet promovuese për ndërgjegjësimin publik, pra jo vetëm të sigurojnë pjesëmarrjen në aktivitete, por edhe të përforcojnë edukimin civil ndërmjet banorëve të komunës në përgjithësi. Shembull: Një aktivitet siç është ai PIVK duhet të ketë postera, fletëpalosje dhe banderola. Një takim i Këshillit duhet të njoftojë për aktivitetin. Gjithashtu, grupi i fo-kusit duhet të marrë ftesa individuale. Radiot lokale dhe televizionet duhet të marrin dek-larata për shtyp apo të inkurajohen për të mbuluar mediatikisht çdo aktivitet.*
- *Diskutim dhe përcaktim i metodave më të mira për të lajmëruar pjesëmarrësit për çdo fazë të procesit. Mos harroni të promovoni. Një aktivitet i konceptuar për shumë njerëz duhet të reklamohet në shumë vende publike ku njerëzit shkojnë shpesh (qendra e fshatit, ndërtesa e komunës, dyqane, shkolla, kafe).*
- *Vendosja e një "Bordi të Informacionit" i cili do të informojë njerëzit mbi aktivitetet që janë duke u zhvilluar nga grupi i PZHL-së për ti mbajtur njerëzit të përditësuar me çfarë ndodh gjatë procesit. Sekretariati mund ta mbajë këtë Bord të përditësuar duke i siguruar kopje të lajmërimeve të bëra grupit të PZHL dhe MADA.*

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

MADA i ofron asistencë teknike grupit të Punës gjatë takimeve të para për të siguruar anëtarët e tij që çdo gjë është nën kontroll. Gjithashtu, MADA do të ofrojë trajnime të mëtejshme për planifikimin e aktiviteteve dhe fushatës së ndërgjegjësimit publik.

Faza 2: Vlerësimi i Gjendjes

Drejtimi i "Vlerësimit nga Komuniteti" është i rëndësishëm për planifikimin e zhvillimit lokal. Përpara se të fillojmë të planifikojmë të ardhmen tonë, duhet të dimë nga t'ia fillojmë. Gjatë kësaj faze do të dëshironim ti përgjigjeshim disa prej pyetjeve të mëposhtme: Kush jemi ne si komunitet? Çfarë është e veçantë për ne? Pse do të dëshironte dikush të jetonte këtu? Pse një kompani do kishte interes të investojë këtu?

Vlerësimi i Gjendjes shërben për të marrë informacionin e duhur rreth dobësive, pikave të forta dhe performancës së komunës, një informacion që do të vinte në pah çështjet kritike me të cilat ndeshet komuna dhe që PZHL duhet të adresojë.

Metodologjia e planifikimit të zhvillimit lokal propozon disa instrumenta për ar-ritjen e një vlerësimi të gjendjes gjithëpërfshirës që përfshin:

- Profilin e Komunës
- Sondazhi i Drejtuesve Vendor
- Analizimi i Banorëve
- Planin e Ideve për Vizionin Komunitar
- Analiza SWOT e Këshillit të Komunës

Në fund të kësaj faze, do të kemi një databazë me informacion cilësor që mund të përdoret për të marrë vendime në afat-shkurtër dhe afat-gjatë, si dhe një listë me çështje kritike që kërkojnë përgjigje nga komuna.

HAPI 4. Mbledhja e informacionit

Veprimtaritë kryesorë të këtij hapi kanë të bëjnë me sa vijon:

- Rishikimin e instrumenteve të zyrtarëve të qeverisjes lokale dhe ndryshimi i tyre në rast nevoje.
- Rishikimi i metodave të sondazheve të qytetarëve dhe ndryshimi në rast nevoje
- Rishikimi i metodave të profilit të komunës dhe ndryshimi në rast nevoje
- Drejtimi dhe ndihma për komitetin e analizës SWOT

Rezultate të pritshme:

- Grupi i PZHL i trajnuar për identifikimin e të gjitha aspekteve për Vlerësimin e Komunitetit
- Profili i Komunës i përfunduar
- Sondazhi i Qytetarëve i realizuar
- Seksioni i Këshillit për Strategjinë i realizuar

Vlerësimi i Komunitetit mundëson një pamje më të gjerë dhe të plotë të statusit aktual të Komunës. Ky vlerësim i mundëson gjithashtu qeverisjes lokale një mundësi të mirë për të aksesuar asetet e komunitetit si tregues të ndryshëm të kapitalit social të cilët premtojnë një analizë më të hollësishme dhe të plotë të aftësisë së ko-muniteti për të përfshirë, zbatuar dhe mbështetur PZHL, për të siguruar të dhëna ob-jektive dhe subjektive, etj.

Profili i komunës

Profili i komunës përfshin të dhëna cilësore mbi një sërë çështjesh përfshirë këtu rritjen e popullsisë, shërbimet sociale dhe edukuese, infrastruktura, burimet njerëzore dhe të buxhetit.

Anketimi i Banorëve

Ky studim lejon grupin e PZHL të mbledhë opinionin e qytetarëve mbi cilësinë e shërbimeve të marra nga qeverisja lokale ashtu sikurse perceptimet mbi besimin dhe përgjegjshmërinë. Për më tepër, anketimi siguron të dhëna kyçe të cilat grupi i PZHL mund t'i përdorë për të matur progresin e bërë përgjatë viteve.

Seksioni i Këshillit të Strategjisë

Përpara se të mësojmë se ku po shkojmë ne duhet të dimë se ku jemi. Ky hap na lejon të bëjmë një vlerësim të situatës aktuale të komunës dhe të krijojmë një pamje më të plotë dhe të saktë të Komunës. Që këtu mund të fillojmë të mendojmë për të ardhmen e komunës. Analiza SWOT – Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Sfidat – lejon të zgjedhurit lokal që të japin mendimet dhe opinionet e tyre për çfarë shkon mirë në komunë dhe çfarë nuk shkon siç duhet, si dhe të bëjnë sugjerime se si mund të përmirësohen fushat prioritare.

Udhëzime kryesore:

Profili i komunës

Qëllimi:

Të sigurojë grupin e PZHL të ketë të dhëna të qarta dhe objektive rreth komunitetit. Kush është përgjegjës? Nënkomiteti i grupit të PZHL për mbledhjen e të dhënave.

Mënyra për ta realizuar:

- Rishikimi i instrumenteve të Profilit të Komunës (manuali), ndryshimi sipas rëndësisë dhe shtimi i pyetjeve për rëndësinë e secilit lokalitet.
- Takim me personelin e komunës dhe identifikimi i burimit të të dhënave.
- Caktimi i anëtarëve të nënkomitetit për mbledhjen e të dhënave nga agjenci të tjera (psh. Autoriteti rajonal i mjedisit, shëndetësisë, arsimit, ujësjellësi, të dhëna të ministrive, etj) sipas kërkesës.
- Përmbledhja e të gjitha të dhënave, grumbullimi, diskutimi dhe identifikimi i pikave kryesore të cilat kërkojnë vëmendje gjatë hartimit të PZHL.
- Përgatitja e përshkrimit të të dhënave me qëllim përdorimin në publikimet e PZHL dhe botime për qëllime të tjera.
- Dorëzimi në sekretarinë e PZHL.

Anketimi i Banorëve

Qëllimi:

Të sigurojë një zë përfaqësues të komunës për informimin e PZHL dhe përfitimi i treguesve kryesorë për matjen e cilësisë së shërbimit dhe çështje të tjera të qeverisë.

Kush është përgjegjës?

Nënkomiteti i grupit të PZHL për Mbledhjen e të Dhënave

Si mund të realizohet?

Më poshtë janë 5 hapat kryesorë për tu ndjekur gjatë hartimit të një anketimi me qytetarët. Udhëzime më të detajuara gjenden në Manual.

1. Finalizimi i instrumentit të anketimit: rishikimi dhe rregullimi për rëndësinë, shtimi i pyetjeve për vendbanime të caktuara dhe testimi tek një numër i banorëve.
2. Përcaktimi i një kampioni të rastësishëm të familjarëve që do të intervistohen.

3. Identifikoni dhe trajtoni intervistuesit - në shumë raste nënkomiteti i mbledhjes së të dhënave të grupit të PZHL mund të drejtojnë trajnimin ose mund të ftojnë vullnetarë për të bërë këtë si p.sh nxënës të shkollave të mesme lokale.
4. Realizimi i anketimit
5. Analizimi dhe dorëzimi i rezultateve me komentet përkatëse tek Sekretariati i grupit të PZHL nga zyrat kombëtare, të komunës, rajonit ose palëve të tjera të in-teresuara.

Profili i komunës mbledh të dhëna sasiore mbi një sërë çështjesh si rritja e popullsisë, shërbimet, infrastruktura dhe financat.

Udhëzime kryesore:

Seanca Strategjike e Këshillit të Komunës

Qëllimi:

Të sigurojë që zyrtarët e zgjedhur formalë dhe jo-formalë të ofrojnë inputet e tyre në zhvillimin e PZHL-së.

Kush është përgjegjës?

Koordinatori lokal i MADA-s dhe Nën-komiteti i Grupit të Planifikimit të Zhvillimit Lokal për Mobilizimin e Komunitetit

Njihet 4 hapa kryesore në drejtimin e Seancës Strategjike të Këshillit.

1. Përcaktimi i kohës dhe vendit për Seancën.
2. Përgatitja e një Raporti për Këshillin rreth qëllimit dhe pritshmërive dhe shpërndarja e tij të të gjithë anëtarët e Këshillit.
3. Drejtimi i Seancës për hartimin e strategjisë
4. Analiza dhe shpërndarja e rezultateve, me komentet përkatëse, te Sekretariati i Grupit të PZHL

ANALIZA SWOT E KËSHILLIT

Drejtimi dhe lehtësimi i Analizës SWOT⁵⁾ të Këshillit

Analiza SWOT është një mjet për auditimin e një organizate dhe mjedisit të saj. Gjithashtu, është një mjet i rëndësishëm për planifikimin dhe i ndihmon zyrtarët lokalë të fokusohen në çështjet kryesore. SWOT ka të bëjë me:

- Fuqitë (Çfarë mund të bëjë një organizatë)
- Dobësitë (Çfarë nuk mund të bëjë një organizatë)
- Mundësitë (kushtet e mundshme të favorshme)
- Sfidat (kushtet e mundshme të pafavorshme)

5) SWOT – Akronim i formuar nga gjerat e para të fjalëve të gjuhës Angleze: Strength, Weak-nesses, Opportunities, Challenges

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme të trajnimit:

MADA ofron asistencë dhe trajnim për Nën-komitetin mbi Mbledhjen e të Dhënave për hartimin e Profilit të Komunës dhe Pyetësorin e Banorëve. MADA ofron gjithashtu trajnim për Nënkomitetin për Mobilizimin e Komunitetit, si dhe lehtëson Seancën Strategjike të Këshillit komunal.

HAPI 5. PJESEMARRJA KOMUNITARE

Rezultatet e pritshme:

- 1) Kontributi i Komunitetit në vizionin e përbashkët, prioritete strategjike dhe plane veprimi.
- 2) Përqindje e lartë e popullsisë merr pjesë në Panairin e Ideve në Komunitet (PIVK) dhe kontribuon me inpute të vlefshme në PZHL.

Veprimtaritë kryesore të këtij hapi kanë të bëjnë me sa vijon:

- Trajnim se si të mundësojmë një Panair të Ideve në Komunitet dhe të sigurojmë pjesëmarrje të gjerë të komunitetit.
- Dërgimi i Panairit të Ideve në Komunitet
- Përcaktimi nëse Grupet e Fokusuara janë të nevojshme për përfshirje të adresuar
- Dërgimi i Grupeve të Fokusuara


Pjesëmarrja e banorëve është një komponent i rëndësishëm në ndërtimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale për të kontrolluar vete të ardhmen e saj. Angazhimi i banorëve në çështje civile ofron me shume zgjidhje dhe vendime të shpejta në lidhje me probleme që prekin të gjithë komunitetin. Banorët që janë të përfshirë në statet e planifikimit, janë më të motivuar të përfshihen në zbatim dhe në monitorim po ashtu. Si rezultat, besimi dhe mirëkuptimi i proceseve të zhvillimit lokal, fryma e komunitetit dhe përgjegjshmëria rriten ndjeshëm, duke shtuar shanset për planifikim dhe zhvillim lokal të suksesshëm.

Një perceptim i rëndësishëm i PZHL-së është se ai përfshin inputin dhe pjesëmarrjen e sa me shumë banorëve dhe se kjo pjesëmarrje është gjithëpërfshirëse me anëtarë nga të gjitha komunat, fshatrat dhe ato grupe sociale që janë zakonisht të përjashtuara nga pjesëmarrja lokale politike, përfshirë ndoshta gratë, të rinjtë, grupet etnike, etj. Në procesin e PZHL-së integrohen dy metodologji kryesore për mbledhjen e inputeve të drejtpërdrejta nga banorët e komunës:

- a) Panairi i Ideve në Komunitet
- b) Grupet e Adresuara të Fokusuara

Te dy aktivitetet kërkojnë ndërgjegjësim të madh të publikut dhe mobilizim të komunitetit. Nënkomiteti i Mobilizimit të Komunitetit të Grupit të PZHL-së është përgjegjës për një organizim të suksesshëm.

Figura 4. Vendosja e Stendave në një Panair të Ideve në Komunitet



Udhëzime kryesore:

Panairi i Ideve në Komunitet

Qëllimi: Të sigurojë që të dëgjohet zëri i sa më shumë njerëzve në komunë – nga çdo fshat – siç është pasqyruar në PZHL.

Kush është përgjegjës? Nëngrupi i PZHL për Mobilizimin Komunitar

Si ta bëjmë atë?

- **Mbajtja e trajnimit me Nëngrupin për mënyrën se si Drejtohet një Panair i Ideve në Komunitet.**
- **Përcaktimi i datave më të mira për takimin dhe kohëzgjatjen për panairin në çdo fshat.**
- **Promovim, reklamim: përdorimi i materialeve të fushatës së ndërgjegjësimit për të maksimizuar efektet**
- **Trajnim te sa më shumë vullnetarëve (p.sh studentë, OJF, etj.) nëse është e nevojshme.**
- **Përgatitja e materialeve prezantuese dhe posterave**
- **Mbërritja herët dhe përgatitja e ambienteve të domosdoshme. Sigurimi i muzikës dhe pijeve nëse është e mundur.**
- **Mos harroni të vendosni një tabelë orientuese për vendndodhjen e panairit jashtë ambientit që të interesuarit ta gjejnë atë.**
- **Mblidhni anëtarët e Grupit të PZHL-së dhe vullnetarët e të gjithë njësive, bëhuni gati për vizitorin e parë!**
- **Kur të kenë mbërritur një numër i konsiderueshëm njerëzish, bëni një prezantim të shkurtër të qëllimit të PZHL-së dhe përfitimeve të komunitetit për pjesëmarrje.**
- **Filloni aktivitetin**
- **Mblidhni të gjithë letrat (flip chart) dhe i dorëzoni në sekretariat për dokumentim dhe ruajtje**
- **Përgatisni raportin e aktivitetit dhe dorëzoni në Sekretariat**

Stendat e Panairit të Ideve në Komunitet

Hyrja: Pjesëmarrësit janë të mirëpritur dhe ju shpërndahen fletëpalosje.

Stenda I: Prezantimi i PZHL-së

Tabelë prezantuese me shpjegim ilustrativ të procesit të PZHL-së me anëtarët e grupit të PZHL të gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Stenda II: Identifikimi i asetëve

Pjesëmarrësit do të identifikojnë asetet e fshatit të tyre. Një hartë e fshatit do të vendoset në mur, mbi të cilën pjesëmarrësit do të identifikojnë praninë e institucioneve, si shkollat, kishat edhe/ose xhamitë, terrenet sportive etj, por gjithashtu dhe praninë e rrjeteve informale. Koordinatori Lokal i MADA-s, anëtarët e Grupit PZHL-së dhe studentët, të trajnuar në teknikat e zhvillimit të komunitetit duke bazuar në këto asetë, do të jenë në krye të këtij ambienti, duke bërë pyetje të përqendruara mbi aftësi të ndryshme, rrjete formale dhe informale, anëtarësimet në shoqata, etj.

Stenda III: Çfarë pëlqej më shumë nga fshati im?

Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë për të vlerësuar qëndrimet pozitive dhe sfidat që bëjnë anën e fortë të fshatit të tyre dhe të komunës.

Stenda IV: Çfarë pëlqej më pak në Fshatin tim?

Pjesëmarrësit shprehen mbi ato që nuk pëlqejnë për jetesën në fshatin dhe komunën e tyre.

Stenda V: Zhvillimi Ekonomik

Pjesëmarrësit ofrojnë sugjerime për përmirësim dhe komentojnë mbi nevojat/preferencat në lidhje me zhvillimin ekonomik.

Stenda VI: Zhvillimi Social

Pjesëmarrësit ofrojnë sugjerime për përmirësim dhe komente mbi nevojat/preferencat në lidhje me çështje të zhvillimit social, përfshirë shërbimet sociale, arsimin dhe shëndetësinë.

Stenda VII: Infrastruktura Publike dhe Shërbimet

Pjesëmarrësit ofrojnë sugjerime për përmirësim dhe komente mbi nevojat/preferencat në lidhje me infrastrukturën publike dhe shërbimet, p.sh rrugët, kanalizimet, grumbullimin e mbeturinave, ujin dhe pastrimin.

Stenda XIX: Vizioni i Përbashkët

Pjesëmarrësit ofrojnë formulime për të shprehur vizionin se si e duan ata të ardhmen e tyre

Udhëzime Kryesore

Mbledhjet e Grupeve të Fokusuara

Qëllimi:

Kush është përgjegjës? Nëngrupi i Grupit të PZHL mbi Mobilizimin e Komunitetit

Si të arrihet?

- *Identifiko grupet e komunitetit që janë të nënpërfaqësuar në Panairin e Ideve në Komunitet.*
- *Fio përfaqësues të çdo grupi për një takim të veçantë të grupit të fokusuar.*
- *Lehtësues për të drejtuar grupin përmes pyetjeve të njëjta të adresuara në Panairin e Ideve në Komunitet si dhe pyetje shtesë që provokojnë vullnetin dhe mundësinë e tyre për të marrë pjesë në veprimtaritë vendim-marrëse të komunës.*
- *Dokumento gjithë përgjigjet dhe dorëzoji ato pranë Sekretariatit të Grupit të PZHL-së për t'u përfshirë në dosjen e informacionit.*

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trainim:

MADA ofron trainim për Panairin e Ideve në Komunitet dhe ndihmon në përcaktimin nëse grupet e fokusuara duhet të mbledhen apo jo.

Pjesëmarrësit ofrojnë formulime për të shprehur vizionin se si e duan ata të ardhmen e tyre

Faza 3: Hartimi i Planit

A e kemi kuptuar mirë?

HAPI 6. PËRPUNIM TË DHËNASH DHE HEDHJE NË STRUKTURËN PARAPRAKE

Rezultatet e pritshme:

- a) Krijimi i Dosjes Informuese të Vlerësimit të Komunitetit
- b) Hartimi i qëndrimit për Vizionin për Komunën dhe identifikim të Objektivave Strategjike
- c) Caktim i Nën-Komiteteve të Fushave Prioritare

Veprimtaritë kryesore të këtij hapi kanë të bëjnë me sa vijon:

- Vlerësim
- Rishikim dhe Interpretim të Informacionit
- Përcaktimi i Vizionit dhe identifikimi i Objektivave Strategjike
- Vendosja e Përparësive

Vlerësimi përfshin profilin e Komunës, rezultatet e Anketimit të banorëve, rezultatet e Seancave të Këshillit të Strategjive dhe të Panairit të Ideve në Komunitet, si dhe kontributet e Grupeve të Fokusuara.

Duke kombinuar çdo pjesë të informacionit në një dosje informuese gjithëpërfshirëse sigurojmë një burim informacioni të vlefshëm jo vetëm për Grupin e PZHL-së për analizën dhe përgatitjen e PZHL, por gjithashtu për veprimtaritë e vendim-marrjes së qeverisjes lokale.

Grupi PZHL dhe Nënkomitetet e fushave Prioritare do t'i përdorin këto inpute për:

- a) Hartimin e një Vizioni të propozuar të komunës
- b) Identifikimin e Objektivave Strategjike për Fushat Prioritare
- c) Hartimin e planeve të veprimit për secilin Objektiv Strategjik
- d) Përgatitjen e studimeve paraprake
- e) Vendosjen e indikatorëve të performancës për të monitoruar progresin e bërë
- f) Sigurimin e llogaridhënies së agjencive përgjegjëse për zbatimin e planit

Udhëzime Kryesore

Finalizimi i Dosjes Informuese të Vlerësimit të Komunitetit

Qëllim:

Kush është përgjegjës?

Sekretariati i Grupit të PZHL dhe i gjithë Grupit të PZHL.

Si ta bëjmë atë?

- Sekretariati përpilon Profilin e Komunës, rezultatet e Anketimit të Qytetarëve dhe analizën fillestare, komentet e Seancës së Këshillit të Strategjive, inputet e panairit, dhe rezultatet e grupeve të fokusit në një dokument të vetëm dhe dorëzimi i tyre gjithë anëtarëve të Grupit të PZHL-së një javë para takimit.
- Kryetari i Grupit të PZHL-së lajmëron për takim Grupin e PZHL për rishikim dhe interpretim

Ekspertiza e Formulimit të Vizionit për Komunën

Qëllimi:

Për të vendosur një vizion afat-gjatë të komunës drejt së cilës PZHL është e orientuar.

Kush është përgjegjës? Grupi PZHL

Si ta bëjmë?

- Koordinatori Lokal i MADA-s ofron trajnim mbi "Interpretimin e të Dhënave dhe Formulimin e Vizionit".
- Sekretariati i Grupeve të PZHL-së vendos nëpër mure rreth ambientit ku mbahet panairi deklarata, flip chart të titulluara "Cili është Vizioni i Komunës për 10–15 vitet e ardhshme?"
- Lehtësuesi⁶⁾ pyet anëtarët e Grupit të PZHL-së të rishikojnë formulimet e vizionit të komunitetit dhe përzgjedh pesë më të mirat që janë më përfaqësuese.
- Lehtësuesi lexon me zë të lartë pesë deklaratimet kryesore që morën vlerësimin më të lartë.
- Lehtësuesi ndan grupin në 3-5 grupe më të vogla (me 4-5 anëtarë secili në vartësi të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve) në varësi të Grupit të PZHL-së.
- Çdo grup i vogël përdor një regjistruar zëri për të regjistruar punën e grupit.
- Çdo grup i vogël ndërton një vizion draft duke u bazuar në pesë formulimet e përzgjedhura nga komuniteti/këshilli dhe shkruan versionin final në flip chart.
- Sekretariati i Grupit të PZHL-së vendos flip chartet e të gjithë grupeve të vogla në mur.
- Çdo grup i vogël prezanton ato përballë të tërë grupit.
- I tërë grupi i PZHL-së voton për formulimin e vizionit më të mirë apo kombinimin e disa formulimeve dhe aprovon versionin final të Vizionit të Komunës.

6) Në rolin e lehtësuesit mund të jetë Koordinatori Lokal i MADA-s ose dikush tjetër i caktuar nga Grupi i Planifikimit të Zhvillimit Lokal

Udhëzime Kryesore

Identifikimi i Objektivave Strategjike të fushave Prioritare

Qëllimi:

Sigurimi që objektivat strategjike janë identifikuar nëpërmjet një konsensusi dhe janë bazuar në informacionin që ndodhet në dosjen informative të Vlerësimit të Komunitetit.

Kush është përgjegjës?

Grupi PZHL

Si ta bëjmë atë?

- Kryetari i Grupit PZHL thërrët për mbledhje të gjithë anëtarët
- Koordinatori Lokal i MADA-s ofron trajnim mbi "Objektivat Strategjike të Zhvillimit"
- Vendosen katër fusha prioritare Nënkomitetesh
- Nënkomitetet ndahen në katër grupe prioritare
- Ato zgjedhin një Kryetar dhe personin që raporton
- Raportuesi i jep letrat me shënime çdo anëtar.
- Kryetari pyet çdo anëtar të lexojnë me zë të lartë pesë çështjet më të rëndësishme të listuara në letër.
- Raportuesi mban shënim dhe liston çështjet kryesore të deklaruara sipas rendit përzgjedhës duke i vënë secilit numrin përkatës të votave e më pas vendos flip chartin në mur.
- Kryetari i grupit të PZHL-së bashkon nënkomitetet në grupin e përbashkët të PZHL-së.
- Kryetarët e nënkomiteteve raportojnë rezultatet e secilit.
- Moderatorin pyet grupin të identifikon anët e përbashkëta dhe marrëdhëniet ndërmjet fushave të ndryshme prioritare.
- Në mënyrë kolektive përzgjidhen 3 – 5 objektiva strategjike
- Moderatorin rikujton se çfarë është një Deklaratë Qëllimi dhe i kërkon nënkomiteteve të ndahen në grupe të vogla dhe të përcaktojnë deklaratime për objektivat (ata mund ta bëjnë këtë dhe në mbledhjen e radhës).
- Kryetarët e nënkomiteteve prezantojnë deklaratimet në Grupin e PZHL-së
- Grupi i PZHL aprovon Objektivat Strategjike të fushës prioritare finale
- Përpara miratimit, Kryetari i Grupit të PZHL i kërkon nënkomiteteve të përcaktojnë një kalendar takimi për zhvillimin e planeve të veprimit.
- Koordinatorin lokal i MADA-s vendos një datë për trajnim tjetër të kryetarëve dhe regjistruarëve të Grupit PZHL dhe Nënkomiteteve të Fushës Prioritare.

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

MADA ofron asistencë teknike Grupit PZHL në hartimin e një deklarate për vizionin e përbashkët dhe identifikimin e objektivave strategjike.

HAPI 7. PUNA E NËNKOMITETIT TË FUSHËS PRIORITARE

Rezultatet e pritshme:

- Nën-Komitetet e Fushave Prioritare janë të trajnuar në moderimin, arritjen e konsensusit

- Planet e Veprimit dhe studimet paraprake të fizibilitetit janë kryer
- Hapat e veprimit dhe projektet janë të prioritizuar sipas çdo objektivi dhe metode transparente
- Indikatorëve për matjen e performances të Identifikuar
- Përgatitje të Draftit të PZHL

Veprimtaritë kryesore të këtij hapi kanë të bëjnë me sa vijon:

- Trajnim të Nënkomiteteve të Fushave Prioritare në lehtësimin/moderimin dhe teknikat e arritjes së konsensusit
- Nënkomitetet e Fushave Prioritare përgatisin planet e veprimit
- Nënkomitetet e Fushave Prioritare përgatisin Studimet paraprake të fizibilitetit
- Nënkomitetet e Fushave Prioritare aplikojnë kriterin e vendosjes së përparësive ndaj hapave të veprimit/projekteve
- Grupi i PZHL-së finalizon planin e zhvillimit lokal paraprak për t'u diskutuar nga komuniteti

Nënkomitetet janë ngritur për të drejtuar punën mbi hapat konkrete/projektet siç sugjerohet nëpërmjet të dhënave të mbledhura dhe inputeve të komunitetit. Nënkomitetet janë të përbërë nga staf i përzgjedhur i qeverisjes vendore me ekspertizë të fokusuar në fushën përkatëse, anëtarë të komunitetit dhe ekspertë të ftuar. Duke pasur parasysh burimet e një komune të veçantë, ekspertë të jashtëm mund të ftohen apo në bazë të nevojave edhe nga institucione rajonale, OJF, dhe të tjerë.

Atëherë kur Hapi i 7-të të jetë plotësuar, Grupi i PZHL-së do të ketë një propozim të plotë për PZHL-në përfshirë:

- Vizionin e Komunës
- Qëllimet Strategjike për secilin fushë prioritare
- Prioritarizimi i Hapave të Veprimit dhe Projektet për të arritur Objektivat Strategjike.
- Studime Paraprake mbi Hapat e Veprimit dhe Projektet
- Indikatorë të matshëm për të ndjekur progresin e bërë në arritjen e rezultateve.
- Një Draft Plan i PZHL

Këto janë të vendosura në një matricë që tregon nivelin deri ku ato janë të dëshiruara dhe/ose të mundshme në afat-shkurt dhe afat-gjatë.

Udhëzime

Trajnim për Lehtësimin dhe Teknikat e Arritjes së Konsensusit

Qëllimi:

Të sigurojë që kryetarët e zgjedhur rishitaz dhe anëtarët e tjerë të secilit komitet të kenë aftësitë e kërkuara për organizimin e një mbledhje efektive dhe arritjes së konsensusit.

Kush është përgjegjës?

Koordinatori Lokal i MADA-s

Si ta bëjmë atë?

- Vendosja e datës dhe kohës së trajnimit
- Rishikim të Modullit të Trajnimit
- Drejtimi i Trajnimit

Trajnim në krijimin e Planeve të Veprimit për Fushën Prioritare

Qëllimi:

Të sigurohet që kryetarët e zgjedhur rishitaz dhe anëtarët e tjerë të rëndësishëm të kenë aftësitë e duhura për krijimin e bazës së PZHL, atë të Planeve të Veprimit të Fushës Prioritare. Ky modul trajnimi përfshin informacion se si të realizojmë studime paraprake dhe të vendosim prioritetet për veprime, projekte dhe çështje, duke pasur parasysh kufizimet e burimeve.

Kush është përgjegjës?

Koordinatori Lokal i MADA-s?

Si ta bëjmë?

- Çaktimi i datës dhe kohës për trajnim
- Rishikim i Modullit të Trajnimit
- Drejtimi i Trajnimit

Trajnim në Monitorimin me pjesëmarrje për rezultate me qëllim identifikimin e indikatorëve dhe teknikat e mbledhjes së të dhënave; të sigurojë që Nënkomitetet e Fushës Prioritare dhe nëngrupet e PME kanë mjetet e duhura për të identifikuar performancën e indikatorëve dhe teknikat e mbledhjes së të dhënave dhe burimet e nevojshme për monitorimin e suksesshëm tek vënia në jetë e rezultateve të PZHL.

Kush është përgjegjës?

Koordinatori Lokal i MADA-s

Si ta bëjmë atë?

- Vendosja e datës dhe kohës për trajnim
- Rishikim të Modullit të Trajnimit

Trajnimi në Monitorimin me pjesëmarrje për rezultate me qëllim identifikimin e indikatorëve dhe teknikat e mbledhjes së të dhënave; të sigurojë që Nënkomitetet e Fushës Prioritare dhe nëngrupet e PME kanë mjetet e duhura për të identifikuar performancën e indikatorëve dhe teknikat e mbledhjes së të dhënave dhe burimet e nevojshme për monitorimin e suksesshëm të implementimit/ rezultateve të PZHL.

Kush është përgjegjës?

Koordinatori Lokal i MADA-s

Si ta bëjmë atë?

- Vendosja e datës dhe kohës për trajnim
- Rishikim të Modullit të Trajnimit

Udhëzime

Zhvillimi i Planeve të Veprimit për Fushën Prioritare

Qëllimi:

Zhvillimi i planeve të veprimit për fushën prioritare për secilin objektiv strategjik që është strategjik, i arritshëm dhe për më tepër, i domosdoshëm për nevojat dhe dëshirat e komunitetit.

Kush është i përgjegjës?

Nënkomitetet e fushës prioritare

Si ta bëjmë?

Në vijim është një kurs veprimi i sugjeruar për veprimtaritë e planifikuara të veprimit të nënkomitetit të fushës prioritare. Procesi i planit të veprimit realizohet në një periudhë gjatë tre- katër takimeve kryesore, me detyra të përcaktuara mirë individualisht ndaj anëtarëve nga njëra mbledhje në tjetrën. Ky është një proces intensiv dhe nevojitet angazhim i plotë i të gjithë anëtarëve për të qenë të disponueshëm dhe të angazhuar për punën. Procesi i lehtësimit është konsideruar si një kombinim i të menduarit, arritjes së konsensusit, diskutimeve me grupet e fokusuara dhe përdorimit të teknikave të prioritarizimit.

Takimi I Parë

1. Kryetari i Nën-Komitetit mbledh grupin, vendos objektivat e aktivitetit, dhe vlerëson progresin e bërë der më tani (vizioni i propozuar, si janë arritur objektivat strategjike, etj.)

2. Nën-Komiteti vlerëson statusin e fushës prioritare dhe i përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Qfarë dimitë për këtë fushë prioriteti? (Profil i Komunes, njohurte, vetjake)
- Qfarë kanë thënë këshilli/banorët? (Anketimi i Banorëve, Seanca e Strategjisë së Këshillit, Inputet e Panalift)
- A duhet të shtojmë diçka tjetër? (anëtarët e Nën-Komitetit kanë mundësinë të japin opinione dhe kontribute të tyre)
- Qfarë është ende e paqarta dhe ka nevojë për sqarime të mëtejshme? (P.sh. nëse inputet e komunitetit janë të paqarta, si "përmirësimi i arsimit", ndoshta një sesion i grupit të fokusuar me mësues dhe prindër do të ndihmontë)
- Qfarë duhet të dimë tjetër?

1. Identifikim i anëtarëve të rinj dhe/ose të ftuarve për të siguruar informacion mbi fushat e adresuara. Për shembull, për fushën prioritare të zhvillimit social, Nën-Komiteti mund të përbëhet nga staf i qeverisjes vendore të specializuar për këtë fushë, drejtues të shkollave lokale ose mësues. Kryetari i shoqatave lokale të prindërve dhe doktorë/intermiere. (A kemi nevojë të mbledhim edhe fermerë lokale, mësues, biznesmenë si anëtarë të këtij grupi?)

(A duhet të ftojme një specialist nga qarku/komuna me e afërt për ndonjë mbledhje të veçantë?) Identifikoni aktivitetet dhe shëroni përgjegjësitë dhe afatet kohore.

Veprimtaritë e mundshme përfshijnë: studime të mëtejshme/studime në një fazë të caktuar të projektit apo plan-veprimit.

Si ta bëjmë?

Takimi I Dytë

- Anëtarët e nënkomitetit raportojnë mbi aktivitetet e tyre dhe diskutojnë rezultatet si një grup i tërë.
- Japin ide dhe zhvillojnë planin paraprak të veprimit për çdo objektiv strategjik.
- Rishikimi i instruksioneve për përgatitjen e studimit paraprak të fizibilitetit.
- Identifikimi i hendeqeve në informacion.

Veprimtaritë e mundshme përfshijnë: studime paraprake të fizibilitetit, këshillim i autoriteteve rajonale mbi mundësitë për financim, rishikim të strategjive të zhvillimit rajonal, dhe studime të mëtejshme, nëse është e nevojshme.

Takimi I tretë

- Anëtarët e nënkomitetit raportojnë mbi aktivitetet e tyre dhe diskutojnë rezultatet në grup
- Përkrahje dhe finalizim i studimeve paraprake të fizibilitetit
- Vendosja e prioritetëve për hapat e veprimit/projektet duke u bazuar në Kriterin dhe Metodologjinë e Prioritarizimit

Takimi I tretë

- Anëtarët e nënkomitetit raportojnë mbi aktivitetet e tyre dhe diskutojnë rezultatet në grup
- Përkrahje dhe finalizim i studimeve paraprake të fizibilitetit
- Vendosja e prioritetëve për hapat e veprimit/projektet duke u bazuar në Kriterin dhe Metodologjinë e Prioritarizimit

Takimi i katërt

- Anëtarët e nënkomitetit raportojnë mbi aktivitetet dhe diskutojnë rezultatet në grup
- Vendosja e përgjegjësisë dhe atarëve kohore për plan veprimi
- Finalizimi i planit të veprimit
- Përkrahje dhe finalizim i indikatorëve të brezanuar nga mjetet e BME
- Dorëzimi i planit të veprimit final tek Sekretarati i Grupit PZHL
- Sekretarati i Grupit të PZHL dorëzon tek Koordinatori lokal i MADA-s për përkrahje

Interval: Prioritarizim Transparent

Prioritarizimi objektiv dhe transparent i hapave të veprimit dhe projekteve është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e planit si dhe në shpërndarjen e fondeve të pamjaftueshme. Metodologjia përfshin një orientim të dyfishtë në prioritarizimin e hapave të veprimit.

Qëllimet kryesore për të arritur një ekuilibër ndërmjet kategorive të mëposhtme të hapave të veprimit/projekteve:

1. ato të mundshmet nga komuniteti me impakt fiskal të vogël
2. ato të mundshmet me kontribut financiar nga komuniteti
3. ato të mundshmet brenda kufizimeve të buxhetit nga qeverisja lokale
4. ato që do t'i propozohen organizatave të huaja donatore dhe/ose të mundshme nga kombinimi i hapave të mësipërm.

Figura Nr.5. Pasqyra Mbi Prioritarizimin

<p>Kutia A</p> <p>Afat-Mesëm</p> <p>Ndikim i Ulët ose Plan Ndikim Fiskal</p>	<p>Kutia B</p> <p>Afat-Gjatë</p> <p>Ndikim i Madh dhe/ose Ndikim Fiskal</p>
<p>Kutia C</p> <p>Afat-Mesëm</p> <p>Ndikim i Madh Fiskal</p>	<p>Kutia D</p> <p>Afat-Gjatë</p> <p>Ndikim i Madh dhe/ose Ndikim Fiskal</p>

Të gjithë elementet e vendosur në Kutinë A duhet të tërheqin vëmendjen e duhur nga komuna. Këto janë plane të vogla që komuna mund t'i implementojë, të cilat shërbejnë gjithashtu për të

rritur entuziazmin e komunitetit dhe të krijojnë besim ndaj procesit. Kutia B, gjithashtu përmban elemente që kanë impakt të vogël fiskal, por që mund të kërkojnë më shumë kohë për t'u zbatuar ose mund të duan kontribute të komunitetit për një periudhë kohe. Kutia C përmban elemente që janë të arritshme në afat-shkurtër por kërkojnë një impakt fiskal më të madh që do të thithet nga buxheti i komunës apo burime të ardhurash jashtë buxhetit. Këto janë konsideruar me prioritet të lartë që kërkojnë vëmendje sapo të ketë fonde të disponueshme.

Si përfundim, Kutia D përmban elemente me kosto më të lartë apo më pak urgjente dhe të mundshme se sa ato të Pasqyrës C.

Pavarësisht se të gjithë elementet që përbëjnë Planin final të zhvillimit lokal janë konsideruar si "prioritete strategjike", që do të thotë se janë zgjedhur në bazë të planit të të menduarit strategjik dhe inuteve nga një përfaqësim i gjerë i komunitetit, situata financiare e qeverisjes vendore orienton se disa elemente mund të financohen përpara të tjerave (që do të thotë implementim i mundshëm).

Në mënyrë që të sigurohet një përzgjedhje transparente dhe objektive e projekteve më prioritare, metodologjia përfshin teknika të prioritarizimit që përmbajnë vlera të renditjes për secilin hap veprimi/projekt ndërmjet shumë kriterëve. Këto kriterë dhe vlerësimi i tyre janë të përcaktuara nga grupi i PZHL-së. Më vonë ato mund të rishikohen nga Këshilli dhe të diskutohen në bazë të rezultateve të PZHL.

Kriteri më i përdorur për të prioritarizuar veprimet apo projektet janë të grupuar si më poshtë:

- (a) Risqet ndaj sigurisë publike dhe shëndetit (siguria e jetës, shëndetësia, siguria, emergjenca, akses)
- (d) Adresimi i nevojave utilitare (ujë, pastrim, edukim)
- (c) Të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme ekonominë edhe/ose nevojat sociale
- (b) Mbrojtje dhe ruajtje të burimeve natyrore
- (e) Përmirësim i eficiencës dhe/ose të gjenerojë burime të reja të ardhurash
- (f) Sigurim i barabartë i shërbimeve dhe mjediseve

Secila kategori mund të detajohet në nënkategori (p.sh për sigurimin e barabartë të shërbimeve mund të jetë: nënkategori për rininë, etj., që identifikohen nga politikat publike si të një rëndësie të veçantë)

Roli i MADA-s dhe kërkesat për trajnim të mundshëm:

MADA ofron trajnim dhe asistencë teknike gjatë kësaj faze të vështirë dhe komplekse.

PERGATITJA E PLAN VEPRIMIT

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

- O frimi i asistencës teknike ndaj Nënkomiteteve të Fushave Prioritare aty ku duhet, veçanërisht në fazën e finalizimit të hapave të veprimit që janë të matshme dhe të mundshme.
- O frimi i asistencës ndaj grupit të PME në vendosjen e njësive për matjen e performances për qëllimet dhe hapat e veprimit.

ANALIZA PARAPRAKE

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

- O frimi i asistencës teknike ndaj Nënkomiteteve të Fushave Prioritare aty ku duhet, veçanërisht në fazën e finalizimit të hapave të veprimit që janë të matshme dhe të mundshme.
- O frimi i asistencës ndaj grupit të PME në vendosjen e njësive për matjen e performances për qëllimet dhe hapat e veprimit.

GRUPI MONTORIMIT DHE VLERESIMIT ME PJESEMARRJE

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

- O frimi i asistencës teknike ndaj Nënkomiteteve të Fushave Prioritare aty ku duhet, veçanërisht në fazën e finalizimit të hapave të veprimit që janë të matshme dhe të mundshme.
- O frimi i asistencës ndaj grupit të PME në vendosjen e njësive për matjen e performances për qëllimet dhe hapat e veprimit.

HAPI 8. JU FOLËT NE DEGJUAM, A E KUPTUAM MIRË?

Rezultatet e Pritshme:

- Draft PZHL e prezantuar për komente
- Komentet e integruar në PZHL versionin Final

Veprimtaritë kryesore janë:

- Draft PZHL e prezantuar tek Kryetarët e Fshatit

ryetarët e PZHL-së prezantojnë Draft PZHL te banorët për komente

ryetarët e fshatit japin opinione për Draft PZHL-në

rupi i PZHL integron sugjerimet ose jep shpjegime të mëtejshme

Përpara se të dorëzohet në Këshillin e komunës, do të ishte mirë të rikthehej në komunitetet për t'u siguruar që drafti final përmban të gjitha pritshmëritë e tyre.

Një raund i dytë mbledhesh në komunë është parashikuar të mbahet për prezantimin e draft PZHL-së. Avantazhi i kësaj përjasaje është se lejon grupin e PZHL-së të marrë angazhimin e komunitetit për t'i realizuar objektivat pavarësisht burimeve të pamjaftueshme të qeverisjes vendore.

Udhëzime

Vajtja nëpër Fshatrat e komunës

Qëllimi:

Të sigurohemi që PZHL është rezultativ dhe në një linjë me pritshmëritë e komunitetit.

Kush është përgjegjës?

Nënkomiteti i grupit të PZHL-së mbi Mobilizimin e Komunitetit dhe Kryepleqtë e fshatrave të komunës

Si ta bëjmë?

Hapat e mëposhtëm shërbejnë për shpërndarjen dhe tërheqjen e opinioneve të Draftit të PZHL-së ndërmjet përfituesve të Komunës:

- *Grupi i PZHL-së mban një takim me Kryepleqtë e fshatrave të komunës për të riparë draftin e PZHL-së, t'u përgjigjet pyetjeve dhe të sigurohen që ata i kuptojnë plotësisht veprimet e propozuara.*
 - *Secili nga Kryepleqtë e fshatrave të komunës / i deleguar dhe përfaqësues të tjerë të grupit të PZHL mbajnë një takim për të diskutuar draftin me banorët.*
 - *Të gjithë rezultatet e arritura regjistrohen dhe i dërgohen grupit të PZHL-së për t'i integruar dhe përpunuar ato më tej.*
 - *Grupi i PZHL-së merr në konsideratë të gjitha inputet dhe i rishikon nëse është e mundshme.*
 - *Sekretariati i Grupit të PZHL-së regjistron të gjitha veprimet, finalizon PZHL-në, dhe ja dorëzon koordinatorit lokal të MADA-s për rishikim përfundimtar.*
- Pas rishikimit të MADA-s Kryetari i Grupit të PZHL-së dorëzon PZHL e propozuar te Kryetari i Këshillit të Komunës për ta futur në agjende ne seancën e ardhshme të Këshillit.*

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

MADA ofron asistencë Grupit të PZHL-së dhe kryepleqve të fshatrave të komunës në prezantimin e draft planit nëpër fshatra.

KAPITULLI III

Miratimi dhe zbatimi i planit të zhvillimit lokal

3.1. Miratimi i Planit të Zhvillimit Lokal Nga Njësitë Vendore

Faza 4: Implementimi i Planit

HAPI 9. INTEGRIMI ME IDENTIFIKIMIN E BUXHETIT/FINANCIMIT

Rezultatet e pritshme:

- A provim në parim të planit, fondet e kërkuara bëhen të mundshme nga Këshilli i Komunës
- Një Buxhet të zhvilluar nga stafi i komunës në përgjigje të prioriteteve të PZHL
- Stafi i Komunës/Grupi i PZHL të trajnuar në identifikimin dhe përgatitjen e propozimeve për kërkime burimesh të fondeve për PZHL-në.

Veprimtaritë kryesore të këtij hapi kanë të bëjnë me sa vijon:

- Stafi i Komunës përgatit buxhetin vjetor
- Ofron trajnim në identifikimin dhe përgatitjen e propozimeve për kërkesë fondesh. Këshilli pranon parimisht PZHL, ofron Çertifikate Vlerësimi të gjithë pjesëmarrësve.

Kuptimi i Planit të Zhvillimit Lokal është të lejojë komunitetet të kontrollojnë dhe të vendosin për të ardhmen e tyre. Ndaj, ky proces nuk mund të ndahet nga procesi i zhvillimit të buxhetit, pasi ky ndodh atëherë kur shpërndahen burimet e pamjaftueshme, në rastin më të mirë sipas nevojave dhe preferencave të komunitetit.

Në zhvillimin e buxhetit stafi i komunës duhet të prezantojë zgjidhje konkrete.

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura dhe inputet, PZHL prezanton një tablo së cilat mund të ishin disa nga këto zgjidhje. Pavarësisht se PZHL përmban një listë gjithëpërfshirëse dëshirash, përmbledhje prioritetesh, disa prioritizime të mëtejshme duhen bërë me qëllim që të përcaktohet në mënyrë transparente se cili nga elementet duhet të financohet në fillim.

Për disa nga elementet që dalin jashtë procesit të buxhetimit për shkak të burimeve të kufizuara, më shumë përpjekje duhet të bëhet për të identifikuar mundësi të tjera financimi. Në rast se kjo e fundit rezulton e pamundur, atëherë Këshilli i komunës mund të rishikojë PZHL në një rishikim vjetor apo 6-mujor.

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

- Të ofrojë asistencë teknike modeste stafit të komunës në përgatitjen e buxhetit që merr në konsideratë qëllimet e PZHL-së dhe planet e veprimit, me fjalë të tjera si të bëhet aktiv buxheti për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e komunitetit.

Roli i MADA-s dhe kërkesat e mundshme për trajnim:

Mundësimi i asistencës teknike ndaj stafit të komunës në përgatitjen e buxhetit që merr në

Udhëzime

Marrja e Aprovimit të Këshillit

Qëllimi:

Të garantohet që Këshilli i komunës ka kohën e mjaftueshme dhe informacionin për të parë, diskutuar, ndryshuar dhe aprovuar PZHL-në. Kjo ofron një mundësi për të shpërblyer punën e madhe të realizuar nga të gjithë pjesëmarrësit.

Kush është i përgjegjës?

Kryetari i Komunës/Grup i PZHL-se

Si ta bëjmë?

- *Kryetari i Komunës i kërkon Sekretariatit të Këshillit të përfshijë në agjendë PZHL-në.*
- *Kopje të PZHL-së shpërndahen te të gjithë anëtarët e Këshillit dhe Kryepjeqtë e fshatrave të komunës jo më pak se një javë përpara mbledhjes së Këshillit.*
- *Kryetari i Komunës prezanton Grupin e PZHL-së dhe prezanton PZHL para Këshillit.*
- *Këshilli diskuton, ofron inpute dhe aprovon apo kundërshton PZHL-në.*
- *Këshilli i ofron anëtarëve të Grupit të PZHL Çertifikatën e Vlerësimit.*

Formulimi i një Buxheti Funkcional

Qëllimi:

Të garantojë që stafi i komunës zhvillon një buxhet që është funksional ndaj kërkesave të PZHL-së, duke përdorur jo vetëm PZHL-në si inputin kryesor, por edhe një proces prioritizimi transparent dhe objektiv për të ndihmuar përcaktimin e atyre elementeve që duhet të mbështeten financiarisht në fillim.

Kush është përgjegjës?

Staff i Komunës me asistencën e grupit të PZHL-së.

Si ta bëjmë?

- Grupi i PZHL thërret për mbledhje Kryetarin e Komunës, Shefin e Zyrës së Financës dhe stafin përgjegjës për të diskutuar zhvillimin e buxhetit dhe se si duhet të informojë PZHL vendimet e shpërndarjes së tij.
- pasi të ketë përcaktuar stafi i komunës të ardhurat, duhet të përcaktohen shpenzimet që duhen bërë në bazë të prioriteteve të PZHL-së, për sa i përket elementeve të buxhetit operativ dhe kapital.
- prioritetet e PZHL duhet të dalin nga listat e prioritarizuara nga Grupi i PZHL në Hapin 7. Grupi i PZHL asiston stafin e komunës në përgatitjen e prezantimit të buxhetit.
- Njëgrupi i Mobilizimit të Komunitetit të PZHL-së dhe Kryepërgjegjësi i fshatrave të komunës mbajnë takime në komunitet për të edukuar banorët se si është hartuar buxheti dhe se si i shërben PZHL-së.
- Grupi i PZHL-së asiston Kryetarin e Komunës në mbajtjen e një dëgjese publike mbi Buxhetin.

Shënim:

Në vitet e ardhshme hartimi i buxhetit do të përfshijë takime të tjera publike për të siguruar gjithëpërfshirjen e komunitetit.

konsideratë objektivat e PZHL-së dhe hapat kryesore, si dhe priorizon vendimet në shpërndarjen e fondeve në mënyrë objektive.

3.2. Monitorimi i Zbatimit të PZHL-së

HAPI 10. PËRSHTATJA E PZHL, IMPLEMENTIMI / FILLIMI I PME

Rezultatet e pritshme:

- Fillohet zbatimi i kalendarit të PZHL-së dhe planit të PME
- PZHL implementohet sipas kalendarit
- Raporte periodike mbi progresin prezantuar zyrtarët e zgjedhur dhe komuniteti.

Veprimtaritë kryesore të këtij hapi kanë të bëjnë me sa vijon:

- Ofrimi i asistencës, ku është e nevojshme dhe e mundshme, tek komunat në transmetimin e strategjive implementuese për PZHL.
- Ofrimi i Asistencës së grupit të PME për monitorimin dhe vlerësimin e progresit.

PZHL do të përmbaje një plan veprimi të detajuar që përcakton përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm të qeverisjes lokale. Përgjegjësia e tyre qëndron në sigurimin se vënia në jetë do të realizohet sipas kuadrit kohor të përcaktuar në kalendar dhe identifikimin e problemeve të paparashikuara më

parë që dalin gjatë fazës së zbatimit. Grupi i PME-së ka si detyrë të monitorojë, të paktën një herë në 3 muaj, progresin e shënuar në drejtim të rezultateve të parashikuara. Është e rëndësishme të theksohet që monitorimi duhet bërë rregullisht, nuk është një detyrë shteruesë, pasi i lejon zyrtarëve dhe grupit të PZHL-së të bëjnë rregullimet e duhura në kohën e përshtatshme. Progresi

Udhëzime

Matja e Performancës

Qëllimi:

Të sigurojë që PZHL është zbatuar sipas kalendarit dhe njësive të adresuara dhe se informacioni është raportuar në mënyrë të rregullt tek Këshilli, stafi dhe komuniteti i komunës.

Kush është përgjegjës?

Nëngrupi i PME-se

Si ta bëjmë?

Kontrolli i rregullt, matja dhe raportimi i rezultateve dhe informacioni mbi performancën përdor njësi matje të thjeshta që janë hartuar për të qenë lehtësisht të kuptueshme nga gjithë komuniteti duke treguar progresin në arritjen e qëllimeve dhe hapave të veprimt. Kur përdoret një herë në çdo 3 muaj, vlerësimi luan rolin e identifikuesit të problemeve që në statet e hershme dhe nga ana tjetër, çdo sukses i arritur më herët mund të tregojë se më shumë mund të bëhet në atë fushë për të tejkaluar pritshmëritë e asaj që është planifikuar. Hartimi i një vlerësimi të thjeshtë lejon akses të komunitetit që mund të mos jetë i aftë të kuptojnë përqindje apo numra llogaritjeje, por që gjithsesi duan të dinë se si janë përmirësuar gjërat.

Shembull i Matricës së Matjes së Performances për përmirësimin e Objektiveve Strategjike dhe Pastrimin e Komunës

Hapi i Veprimt	Rruga drejt suksesit	Duhet më shumë punë	Ndihmë!	Shënime!
Ftesë grupimeve lokale rinore / të tjerë të bashkë-financojnë për ditë pastrimi		X		Takime të mbajtura, por jo përcaktime datash për pastrimin e parë
Kontraktim të shërbimeve për grumbullimin e mbetjeve për një herë të vetme / mbledhje mujore në të gjithë fshatrat			X	Rezultatet e Anketimit treguan për mungesë motivimi për të paguar – kërkim të burimeve të tjera për ndërgjegjësim publik në rritje të interesimit
Parashikimi i një gjobe për zbrazje jologjore dhe një metode për të përforcuar kontrollin	X			Gjoba është përcaktuar nga Këshilli, më 2 raste ka siguruar përmirësim të situatës!

i arritur ose jo duhet më pas të raportohet në komunitet nëpërmjet mjeteve të informimit publik si media lokale, mbledhjet e Këshillit të Komunës, posterave në qendrat e fshatrave të komunës, etj.

PZHL përmban gjithashtu edhe një matricë për matje të performancës që regjistron indikatorët bazë të vlerësimit dhe adresimet në të ardhmen. Të dyja këto njësi matjeje mund të përdoren në përputhje me njëra-tjetrën. Është me rëndësi që informacioni që merret prej tyre të raportohet tek Këshilli, stafi, dhe komuniteti i komunës në sa më shumë forume të jetë e mundur.

Fusha Prioritate e PZHL-së: Infrastruktura publike

Objektivi Strategjik i Shërbimeve: Përmirësim dhe Pastrim i Komunës

Hapi i Veprimit	Matja e Performances	2008 Fakt	2009 Target	2010 Target	Metoda e Mbledhjes së të Dhënave
Ftesë grupimeve lokale rinore / të tjerë të bashkë-financojnë për ditë pastrimi	% e banorëve të pyetur mbi nivelin e vlerësimit të pastrimit të komunës si "mirë" dhe "shkëlqyeshëm"	30%	35%	50%	Anketimi i Banorëve
	# i ditëve të pastrimit	0	2	4	Regjistrimet e Komunës / organizatave

Komuniteti

Përfaqësues të organizatave kryesore të komunitetit
Individë të njohur e të respektuar në komunitet
Përfaqësues të grave, rinisë dhe papunëve

Agro-industria
dhe biznesi


Drejtnesit e punëdhënësve kryesorë të zonës
Përfaqësues të shoqatave të fermerëve
Përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë
Bizneset lokale dhe shoqatat e tyre

Qeveria

Zyrtarë të qarkut
Zyrtarë të komunave përreth
Zyrtarë të zhvillimit të aftësive rajonale si p.sh. nga Drejtoria Arsimore,
Drejtoria Shëndetësore dhe Drejtoria e Shërbimit Këshillimor të qarkut

Një Përmbledhje Strategjike e Pesë Komponentëve të Praktikës së Zhvillimit Ekonomik

Mbledhja e të Dhënave dhe Analiza e Aktiviteteve	Zhvillimi Organizativ	Zhvillimi i Infrastruktura	Zhvillimi i Bizneseve	Zhvillimi i Projekt-Postitore	Zhvillimi i Rrethit të Përafshirë të Komunitetit
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i një vizioni të përbashkët mes partnerëve të komunitetit ◆ Krijimi i një Plani Strategjik me Objektivat e Mëshirë ◆ Zhvillimi i një Analize ekonomike të Komunitetit për identifikimin e forcave të tregut 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mbledhja e të dhënave mbi kapacitetin e infrastrukture: ujë, kanalizim, përmbijë, suli, shërbime komunale, transportimi i mbetjeve, telekomunikacione ◆ Investuarizimi i paqëve të biznesit, vendndodhjeve dhe ndërrësive ◆ Identifikimi i hendeqeve në facilitete, kapacitete, fusha me mundësi për rrugë potenciale, fusha që kanë nevojë për përmirësim 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i një plani për krijimin, përmirësimin, apo përmirësimin e elementeve të infrastrukturës ◆ Hartimi i një plani zhvillues për përmirësimin apo krijimin e banesave dhe hapësirave të përkatshme për zhvillim ◆ Identifikimi i tokave për përdorim të përshatshëm 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Identifikimi i përvojave aktuale për Mirënjohje dhe Zgjerim ◆ Identifikimi i mbledhjes aktuale për Zhvillim të Spërnatës ◆ Identifikimi i përvojave aktuale për të krijuar biznese të reja ◆ Përcaktimi i programeve dhe shërbimeve për zhvillimin e qendrës së zonës së banuar ◆ Identifikimi i hendeqeve në secilin apo në të gjithë elementët e sipër përmendur ◆ Hartimi i analizave të afro-përpunimit për të identifikuar inpute biznesore që përkatshme për kluster 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Zhvillimi i një Analize Tregu të Punës ◆ Studimi i Demografisë së Komunitetit dhe rëndësi të tij ◆ Analizim të kapaciteteve dhe përkatshmërisë të shtetit të arsimi për të përdoruar shërbime aktuale dhe të ardhshme të forcës punëtore 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Investuarizimi i zonave të arratësuar për turizëm ◆ Shërbime dhe pajisime të reja ◆ Studimi i afërsisë ekonomike për identifikimin e burimeve të tregut ◆ Identifikimi i mundësive të komunitetit për investuarizimin dhe shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i burimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut
<p>Aktivitetet e Planifikimit dhe Zbatimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Mbledhja e një Liste me gjen për tu bërë ◆ Marja e Vendimit mbi Strategjinë që duhet implementuar ◆ Përcaktimi dhe bërija e marrëveshjeve mbi rolet dhe përgjegjësitë – kush do të bëjë çfarë, sipas kalendrit ◆ Studim dhe vlerësim i modeleve të ndryshme të organizatave ◆ Zhvillim i mundësive për bashkëpunim rajonal 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i një plani për përmirësimin e mbledhjes dhe zgjerimit e kapaciteteve të biznesve ekzistuese ◆ Krijimi i një Plani për zhvillimin apo përmirësimin e sistemit të mbledhjes së zhvillimit të qëndrueshëm ◆ Hartimi i një plani për përmirësimin dhe shërbimeve të biznesit të reja ◆ Hartimi i planit për zhvillimin e qendrës së Komunitetit ◆ Bërija e marrëveshjeve për zhvillimin e tokës për përdorim të përshatshëm 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i planifikimit të organizatave lokale, rajonale e shërbimeve të shtetit ◆ Përcaktimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i planifikimit të organizatave lokale, rajonale e shërbimeve të shtetit ◆ Përcaktimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i planifikimit të organizatave lokale, rajonale e shërbimeve të shtetit ◆ Përcaktimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut
<p>Aktivitetet e Identifikimit të Burimeve</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Zhvillimi i interesave të partnerëve dhe mundësive për investim në nivel bashki, qarku, shteti, privat ◆ Përcaktimi i burimeve njerezore si të nevojshme dhe të aftë të implementojë aktivitetet të paguara apo vullnetare 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Identifikimi i burimeve kapitale sic është tërësi i tokave të naturs, kapitalit operimtar, autoriteteve zhvilluese ◆ Identifikimi i burimeve dhe kapaciteteve për zhvillimin e hapësirave të shtetit, sistemit të arsimit, kujdesit shëndetësor, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Krijimi i vlerësimeve për mundësi të biznesit të ri ◆ Hartimi i planit për zhvillimin e qendrës së Komunitetit ◆ Bërija e marrëveshjeve për zhvillimin e tokës për përdorim të përshatshëm 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i planifikimit të organizatave lokale, rajonale e shërbimeve të shtetit ◆ Përcaktimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Hartimi i planifikimit të organizatave lokale, rajonale e shërbimeve të shtetit ◆ Përcaktimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut ◆ Identifikimi i hendeqeve në shërbimeve të tregut



AGJENSIA E ZHVILLIMIT TË ZONAVE MALORE

PER NJE ZHVILLIM TE QENDRUESHEM TE ZONAVE RURALE MALORE

MADA ka si qëllim:

- Përmirësim i cilësisë së jetës së njerëzve
- Inkurajim i zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm
- Mbështetje të aktiviteteve të zhvillimit me bazë pjesëmarrjeje
- Targetim dhe mbështetje e sektorit privat

MADA synon të luajë rol kryesor në:

- Nxitjen dhe mbështetjen zhvillimin ekonomik të zonave rurale malore
- Mbështetje dhe influencim në politikat zhvilluese të Qeverisë
- Koordinimin e aktiviteteve në nivel lokal dhe kombëtar
- Krijimin e një rrjeti partneriteti me donatorët, organizatat, sektorët publikë dhe privatë për përgatitjen e projekteve dhe financimin e tyre në zonat malore.

MADA: Rr. "Shinasi Dishnica", Nr. 100 (afër Selvisë)

Tel.&Fax: +355-42267544; Tel.: +355 42267542

www.redeval.org email: mada@redeval.org